



STUDIME PASDIPLOMIKE-CIKLI I DYTË
PROGRAMI STUDIMOR: E DREJTA CIVILE

TEZA:

**“Impakti i prindërisë së përbashkët pas shkurorëzimit të martesës në
mirëqenien e fëmijëve-studim krahasues”**

Kandidat:
Azbije Luma

Mentor:
Prof.dr. Artë Mero

Tetovë, 2024

DEKLARATA E AUTORIT

Unë, Azbije Luma, studente në Fakultetin Juridik në Universitetin e Europës Juglindore Tetovë, deklaroj se jam autore e punimit dhe mbaj përgjegjësi për origjinalitetin e këtij punimi. Informacioni i grumbulluar nga puna e botuar ose e pa botuar e të tjerëve është e cituar në tekst dhe referencat janë shënuar në listën e burimeve të literaturës.

Azbije Luma

Lektoroi :

MSc. Esat Husejni

ABSTRAKT

Ky hulumtim është i lidhur me fatin e fëmijëve pas shkurorëzimit të prindërve, mundësitë dhe llojet e kujdesit të tyre ndaj fëmijëve.

Rëndësi i jepet familjes, rolit të saj në shoqëri, problemet që dalin nga marrëdhëniet brenda saj, nga ajo se sa ligji aktual për familjen i kënaq nevojat që ndërlidhen me të drejtën dhe obligimet që janë pjesë e jetës familjare dhe anëtarëve të familjes.

Vëmendje e veçantë i përkushtohet impaktit të prindërisë së përbashkët pas shkurorëzimit në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, bashkë me efektin e saj te mirëqenia e fëmijëve në të gjitha aspektet e jetës dhe zhvillimit të tyre. Ideja është që kujdestaria mos t'i ndahet vetëm njërit prind, por prindërit të merren vesh mes vete dhe të mund që fëmijët edhe pas shkurorëzimit të jetojnë jetë normale dhe të kenë vëmendjen nga të dy prindërit, pra ata në asnjë mënyrë nuk duhet të jenë në situatë të tillë për të zgjedhur dhe gjithmonë të bëjnë plane të përbashkëta zhvillimore për fëmijët e tyre.

Fjalët kyçe: *Familja, fëmijët, shkurorëzimi, prindërimi, ligji.*

АБСТРАКТ

Ова студија е во врска со судбината на децата после разводот на родителите, можностите и видовите на нивната грижа.

Значење и се дава на семејството, нејзината улога во општеството, проблемите кои можат да излезат од меѓусебните односи во семејството, од тоа колку актуелниот закон за семејството ги задоволува потребите и обврските поврзани со правата и задолжителствата на членовите на семејството.

Посебно внимание му се дава на влијанието на заедничкото родителство после разводот во законодавството во Република Северна Македонија, заедно со неговиот ефект врз благосостојбата на децата во сите аспекти на нивниот живот и развој. Целта е да не му се дава грижата на децата на еден родител, туку родителите да се договорат помеѓу себе и да можат децата и после разводот да живеат нормален живот и да имаат внимание од двата родители, така што нема потреба да бидат во ситуации да изберат и секогаш да прават заеднички развивачки планови за своите деца.

Клучни зборови: *Семејството, децата, разводот, родителството, законот.*

ABSTRACT

This research is related to the fate of children after the divorce of parents, possibilities and types of care for them.

Emphasis is given to the family, its role in the society, the problems arising from relationships within it, as well the current law of family satisfies the needs and obligations associated with the rights of family members.

Special attention is dedicated to the impact of joint parenting after divorce in the legislation of the Republic of North Macedonia, along with it's effect on the well-being of children in all aspects of life and development.

The idea is that custody should not be exclusively given to one parent, but that parents should come to an agreement between themselves. This aims to ensure that children, even after divorce, lead normal lives and receive attention from both parents, so they should not be in a situation to choose, and parents should always make joint developmental plans for their children.

Keywords: *Family, children, divorce, parenting, law.*

PËRMBAJTJA:

1.Lënda e hulumtimit	8
2.Qëllimi i hulumtimit.....	8
3.Hipotezat.....	9
4.Kornizat metodologjike të hulumtimit.....	10
5.Rëndësia e hulumtimit.....	10
HYRJE.....	11
1.FAMILJA.....	12
1.1. Zhvillimi historik i marrëdhënieve familjare	14
1.2. Zhvillimi i marrëdhënieve familjare – në të drejtën romake.....	15
1.3. Zhvillimi i marrëdhënieve familjare – në të drejtën mesjetare.....	16
1.4. Zhvillimi i marrëdhënieve familjare – në të drejtën zakonore shqiptare.....	17
1.5.Zhvillimi i marrëdhënieve familjare – në të drejtën e sheriatit.....	18
2.MARRËDHËNIET JURIDIKO-PERSONALE NË FAMILJE	
2.1.Jeta familjare.....	19
2.2. Funksionet e familjes.....	20
2.3. E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare.....	23
2.4. Të drejtat dhe detyrimet familjare.....	24
2.5. Tendencat bashkëkohore të familjes dhe roli i të drejtës familjare.....	25
3.SHKURORËZIMI	
3.1. Nocioni i shkurorëzimit dhe shkaqet kryesore për shkurorëzim	27
3.2. Pasojat e shkurorëzimit në marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve.....	28
3.3. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve gjatë procedurës së shkurorëzimit.....	30

3.4. Mediacioni si alternativë e zgjidhjes së kontestit.....	31
3.5. E drejta prindërore pas shkurorëzimit.....	33
3.6. E drejta e përdorimit të banesës familjare.....	35
3.7. Parimi i interesit më të lartë të fëmijës.....	37
3.8. Konventa për të drejtat e fëmijës.....	38
4. PRINDËRIA E PËRBASHKËT – JOINT CUSTODY	
4.1. Nocioni i përgjithshëm i prindërisë së përbashkët.....	40
4.2. Veçoritë e prindërisë së përbashkët.....	41
4.3. Rëndësia universale e përfshirjes së prindërisë së përbashkët në kodin civil të ri të RMV.....	43
4.4. Impakti i prindërisë së përbashkët pas shkurorëzimit të martesës në mirëqenien e fëmijëve.....	45
4.5. Avantazhet dhe disavantazhet e prindërisë së përbashkët pas shkurorëzimit.....	48
4.6..Aspektet krahasimore të kësaj materje juridike me disa shtete evropiane-Francë, Austri, Suedi, Gjermani.....	50
4.7. Praktika gjyqësore lidhur me shkurorëzimet dhe kujdestarinë e fëmijëve – raste nga Gjykata Themelore Tetovë	61
4.8. Raste nga Qendra për Punë Sociale – Tetovë.....	67

PËRFUNDIME

REKOMANDIME

BIBLIOGRAFIA

1.Lënda e hulumtimit

Ajo që është aktuale dhe që ndërlidhet me “Prindërinë e përbashkët pas shkurorëzimit të martesës në mirëqenien e fëmijëve, ka të bëjë me një dukuri juridike tejet delikate dhe gjithpërfshirëse. Ky punim është i orientuar kryesisht në analizën e të drejtave prindërore pas shkurorëzimit të martesës. Aktualisht në jurisprudencën e RMV-së, të drejtën prindërore e trajton me shumë mangësi “Ligji për familjen”.

Nga ana tjetër aspektet e rrjedhave shoqërore e politike edhe në sferën e jurisprudencës kërkojnë trajtim thelbësor që do të ishin kompatible me format e jurisprudencës europiane.

Prandaj edhe rekomandohen refomat rrënjësore edhe në sferën e drejtësisë. Në vijim përqëndrimi im është në drejtim të detektimit të këtyre rekomandimeve përmes hulumtimit krahasues të disa shteteve anëtare të Bashkimit Europian. Kuptohet në asnjë mënyrë nuk është devijuar nga specifikat e shoqërisë së RMV-së duke përdorur shabllone të imponuara, por është insistuar të gjenden modalitete europiane që do të jenë kompatible me karakteristikat e shoqërisë në RMV.

2.Qëllimi i hulumtimit

Për shkak të specifikave që në vete ngërthen ky hulumtim, është vështirë të përshkruhet baza dhe qëllimi i tematikës që përfshihet në të. Kjo vjen nga ajo se dukuria e shkurorëzimit nga këndvështrimi juridik e ligjor ende trajtohet në suaza të Ligjit për familje. Nga ana tjetër, rekomandimet që vijnë nga vendet e Bashkimit Europian, flasin për domosdoshmërinë e përpilimit të një ligji të veçantë ku do të rregulloheshin të gjitha aspektet që dalin nga shkurorëzimi i familjes dhe të drejtat dhe obligimet që pasojnë mbas shkurorëzimit, me theks të veçantë i rolit të prindërisë së përbashkët. Ky punim ka për qëllim që t’i detektojë ato zgjidhje juridike të inkuorpuara në legjislacionet nacionale të shteteve anëtare të Bashkimit Europian dhe të shteteve aspirante siç është edhe RMV-ja, e ku rregullativat ligjore të shkurorëzimit dhe kujdesi i fëmijëve pas shkurorëzimit janë pjesë e Ligjit për familjen.

Në RMV në bazë të statistikave është rritur dukshëm numri i shkurorëzimeve dhe për fatin e fëmijëve pas shkurorëzimit mbetet të vendos Qendra për Punë Sociale. Qëllimi i këtij punimi është t'i kushtojë vëmendje të veçantë prindërimit, gjegjësisht prindërisë së përbashkët pasi që dhuna emocionale ndaj fëmijëve nuk është hulumtuar, pra nuk është studiuar mjaftueshëm dhe në mënyrë adekuate.

3.Hipotezat

Hipotezat që parashtrohen në këtë punim janë:

Hipoteza e parë: Pas shkurorëzimit, një numër i konsiderueshëm i prindërve të shkurorëzuar bien dakord për prindëri të përbashkët, andaj në këto raste, me ndërprerjen e konflikteve të ndërsjella mes prindërve të shkurorëzuar, në fakt plotësohen kushtet për kryerjen e prindërisë së përbashkët. Funksionimi i institutit prindëri e përbashkët i liron fëmijët nga stresi sepse edhe pas shkurorëzimit ata do të jenë me prindët e tyre në realizimin e aktiviteteve të përbashkëta familjare.

Hipoteza e dytë: Forma tjetër e zbutjes së kontesteve gjatë shkurorëzimit të prindërve, apo arritjes së marrëveshjeve rreth kujdesit të përbashkët të fëmijëve është Mediacioni (ndërmjetësimi). Përmes mediacionit në mënyrë „paqësore” dhe pa pasoja mund të arrihet në rregullimin e shumë kontesteve edhe në konfliktet familjare, përfshi shkurorëzimin, të drejtën prindërore etj.

Hipoteza e tretë: Që nga lindja, fëmija ka adresën e banimit në të cilën jeton bashkë me prindërit. Në rast të shkurorëzimit, banesa familjare mbetet vendbanimi ku do të qëndrojë fëmija. Në këto raste kur prindërit kanë marrëveshje për kujdes të përbashkët – pjesë përbërëse e marrëveshjes; si e drejtë prindërore është edhe marrëveshja rreth asaj se çka do të jetë banesë e fëmijës, gjithnjë në interes maksimal të fëmijës, si e drejtë e pakontestueshme që fëmija të ketë banesë. Në raste të shkurorëzimit, prindërit poqese merren vesht edhe për adresën se ku do të jetojnë fëmijët nën kujdesin e prindërve, do të jetë interes jetik për vet fëmijët, sepse në këto rrethana, fëmijët do të jenë më pak të traumatizuar e më pak të stresuar.

4. Kornizat metodologjike të punimit

Janë përdorur metodat themelore siç janë: analizat dhe sintezat, si dhe metodat e përgjithshme shkencore ku hyjnë metodat statistikore dhe ato komparative. Kuptohet për realizimin e suksesshëm të këtij punimi është përdorur metoda juridike. Meqë çdo normativë juridike kërkon përpikmëri në zbatim në një shoqëri të caktuar me institucione demokratike e funksionale, atëherë metodologjia sociologjike e trajtimit të punimit ka qenë e domosdosshme. Shpejtësia dhe intensiteti i zbatimit të ligjit gjithësesi varet nga niveli dhe kultura politike në shoqëri. Pra metodat sociologjike të punimit janë një nga bazat e hulumtimit.

Duke marrë parasysh rrjedhat e zhvillimit të problematikës që ndërlidhen me shkurorëzimin e martesës dhe kujdesin e prindërve pas shkurorëzimit, është më se e nevojshme të bazohem edhe në metodologjinë historike që del nga ndryshimi i rregullativave ligjore në trajtimin e shkurorëzimit dhe të kujdesit të prindërve ndaj fëmijëve pas shkurorëzimit të martesës. Një prej elementeve kyç të përgatitjes së këtij studimi qëndron edhe në metodën e grumbullimit të dhënave. Për ta realizuar me përpikmëri metodën e grumbullimit të të dhënave, duhet bazuar në praktikat gjyqësore në RMV.

Aspektet komparative si pjesë plotësuese e metodave hulumtuese gjithësesi janë të rëndësishme, andaj vëmendje e veçantë i është përkushtuar edhe rasteve të studimit në vendet evropiane duke u nisur nga ligjet përkatëse të këtyre vendeve.

5. Rëndësia e punimit

Rëndësi do t'i jepet familjes, rolit të saj në shoqëri, problemet që dalin nga marrëdhëniet brenda saj, nga ajo se sa ligji aktual për familjen i kënaq nevojat që ndërlidhen me të drejtën dhe obligimet që janë pjesë e jetës familjare dhe anëtarëve të familjes. Në suaza të këtyre raporteve, me rëndësi të vecantë janë të drejtat dhe mirëqenia e fëmijëve, duke u nisur nga interesi më i lartë i fëmijës që është normativë juridike e pakontestueshme dhe pjesa më e ndjeshme e kësaj materie. Vëmendje të vecantë duhet përkushtuar impaktit të prindërisë së

përbashkët pas shkurorëzimit në legjislacionin e RMV, bashkë me efektin e saj tek mirëqenia e fëmijëve në të gjitha aspektet e jetës dhe zhvillimit të tyre.

Hyrje

Me vet faktin se bëhet fjalë për një tematikë nga lëmia pothuajse tejet senzitive e jurisprudencës bashkëkohore, jam përpjekur për një angazhim paksa studiues e të shumanshëm, sepse zgjidhja optimale e problematikës nuk mund të mbështetet vetëm në bazë të nomenklaturës juridike, por trajtimi optimal dhe i drejtë i saj detyrimisht bazohet edhe në sferat tjera shkencore siç janë aspektet psikosociale, ato ekonomike, kulturore – veçmas të kulturave tradicionale, po pse jo edhe të sferave politike.

Meqë tani për tani problematikën e shkurorëzimit e rregullon vetëm Ligji për familjen, kjo vetvetiu tregon se është i detyrueshëm edhe shqyrtimi hulumtues i ligjeve tjera dhe konventave ndërkombëtare që e prekin dhe e trajtojnë të njëjtën problematikë. Menjëherë vërehet se disa shtete, problemet që ndërlidhen me shkurorëzimin, i trajtonë jashta ligjit mbi familjen, me një ligj të veçantë ose përmes Kodit Familjar (Shqipëria, Kosova, Bullgaria, Serbia etj.).

Pavarësisht se ku dhe si zgjidhen problemet familjare përmes ligjit, ajo që është parësore, prej ku ngjizet thelbi i shoqërisë së njerëzimit, madje që nga koha e matriarhatit, gjegjësisht nga ajo e patriarhatit, familja ka luajtur dhe vazhdon ta luajë rolin e pakontestueshëm të zhvillimeve të gjithëmbarshme të njerëzimit, prandaj vëmendje të veçantë do t'i përkushtohet zhvillimit historik të familjes dhe marrëdhënieve ndërfamiljare si dhe atyre mbrenda saj. Aspekte nga ky zhvillim do nxirren nga e drejta romake, nga ajo mesjetare, nga e drejta zakonore shqiptare, përkatësisht Kanuni i Lekë Dukagjinit, nga e drejta e sheriatit, gjegjësisht nga ajo kuranore. Punimi zë fill nga një problem, ndonëse jo aq të ri, por vetëm pjesërisht të zgjidhur dhe jo mjaft i sistematizuar, (siç është problematika e shkurorëzimit të martesës dhe prindëria e përbashkët pas shkurorëzimit), përmes analizës dhe hipotezave, u përpoqa të vij në rezultate të reja, që padyshim kanë rëndësi të veçantë.

Meqë nocioni i prindërisë së përbashkët në RMV, nga aspekti juridik, është ngusht i lidhur me “Ligjin për familjen”, e arsyeshme është, që të bëhet përpjekje që mirëfilli të jepet definicioni

(përkufizimi) kuptimplotë i institucionit familje. Kalimthi arrita t'u bëj një vështrim çështjeve të jetës familjare ndërmjet bashkëshortëve, fëmijëve, prindërve dhe antarëve tjerë të familjes.

Duke marrë parasysh se rëndësi të veçantë në trajtimin e jetës martesore ka shkurorëzimi, pasi me këtë problematikë ballafaqohen, përveç gjykatave edhe entet sociale dhe ato të mediacioneve. Theks të veçantë i kam dhënë edhe kësaj forme të marrëveshjes në zgjidhjen e këtyre kontesteve.

Pasiqë shtjellimi i temës prindëria e përbashkët pas shkurorëzimit ndërlidhet me vet familjen dhe funksionimin adekuat të saj deri në rregullimin e funksionimit normal, është mirë të shqyrtohet nocioni i institucionit familje dhe kalimthi të cekën aspektet juridike e ligjore të krijimit dhe funksionimit të këtij institucioni shoqëror, si dhe disa aspekte të nocionit familje.

1.FAMILJA

Familja në fakt, është bashkësi njerëzore (humane), universale të cilën e përbëjnë partnerë të rritur dhe fëmijët e tyre, si dhe pjesëtarë tjerë të gjinisë më të largët të cilët jetojnë bashkërisht.

Të flasësh për familjen si institut është një çështje tejet e komplikuar, e aq më tepër kur ajo ka të bëjë me çështjen për të drejtat prindërore, përkatësisht për mirëqenien e fëmijëve gjatë ushtrimit të këtyre të drejtave.

Familja paraqet formën e bashkësisë shoqërore e cila përbëhet nga dy persona me gjini të kundërt dhe nga pasardhësit e tyre. Çështja e familjes është një çështje shumë komplekse dhe si e tillë ajo studiohet në aspekte të ndryshme siç është aspekti juridik, sociologjik, ekonomik, pedagogjik etj.

Njeriu, si rregull, lind, jeton dhe vdes në familje. Familja është celula më e lashtë e organizimit shoqëror.¹ Po ta studjojmë familjen nga aspekti juridik, ajo paraqet grup shoqëror të njerëzve të lidhur me martesë dhe gjini, ku në mes tyre egzistojnë shumë të drejta dhe detyrime të parapara në ligje të veçanta. Nga përkufizimet e familjes mund të dalin disa veçori të veçanta të familjes. Ajo paraqet një bashkësi shoqërore që do të thotë se është një formë e

¹ Abdulla Aliu-Haxhi Gashi.E drejta Familjare, fq.41

organizimit të shoqërisë. Mirëpo kjo formë e organizimit dallon nga organizimet tjera, sepse këtë e përbëjnë personat që në mes veti kanë lidhje specifike. Këta janë individë të cilët janë të lidhur me martesë ose bashkësi jashtëmartesore, si dhe individë të lidhur me gjini në mes vete si prindërit dhe fëmijët. Këtu bëjnë pjesë edhe personat e lidhur në gjini të gjakut si : vëllau, motra, gjyshi, gjyshja etj.

Familja është bashkësi shoqërore e cila i mbron dhe orienton anëtarët e vet, sidomos fëmijët. Familja apo ambienti familjar, është vendi kryesor ku fëmijët dhe të rrinjtë mësojnë kodet e sjelljes, mësojnë çka është e ndaluar dhe çka është e lejuar në raport me botën e jashtme.²

Familja si institucion i veçantë ka pasur dhe ka edhe sot funksione dhe detyra të shumëfishta në formimin, edukimin, ngritjen, zhvillimin dhe afirmimin e anëtarëve të vet, e sidomos fëmijëve. Ajo si e tillë ka pësuar shumë ndryshime gjatë zhvillimit të njerëzimit në tërësi. Sa i përket çështjes së përkufizimit të familjes në suaza të sociologjisë do të kisha përmendur përkufizimin e Xhon Lokut; familja mund të përkufizohet si “grup i personave të lidhur me lidhjet bashkëshortore dhe gjakore ose me përvetësim, adoptim.”³

Paraqitja e familjes në kohë dhe hapësirë është e ndryshme. Por në të gjitha shoqëritë ekziston e ashtuquajtura familja bërthamë që në esencë përfshin bashkëshortët dhe fëmijët e tyre.⁴

Duke e njohur mirë rëndësinë e familjes, Aristoteli pat përfunduar se familja është bërthama e shoqërisë. Ajo paraqet ambientin ku fëmijët fillojnë të formohen, zhvillohen dhe aftësohen për jetë. Aty mësojnë bazën e edukimit dhe sjelljes, andaj vetë familja është faktor kryesor që ndikon në mirëqenien e fëmijëve. Ligji për familjen i RMV-së nuk përmban një përkufizim. Familja mund të kuptohet si “një bashkësi e gjallë e prindërve, fëmijëve dhe të afërmeve të tjerë të cilët, kanë të drejta dhe detyrime të ndërsjella, si dhe një bashkësi tjetër themelore e jetës

² Ragip Halili. Kriminologjia, fq.276

³ Dida, A. Fillet e sociologjis, fq.303

⁴ Hasan Jashari. Familja dhe bashkësia, fq.10

në të cilën ndodhen fëmijët." Pra familja mbetet si "një rreth, një grup të afërmish që kanë të drejta dhe detyrime të ndërsjella".

Sipas vështrimit tradicional „familja është njësi natyrore si dhe njësi themelore e shoqërisë. Sipas këtyre qëndrimeve shoqëria ekziston falë ekzistimit të familjeve, pra shoqëritë reale dhe shtetet janë vetëm shkak i ekzistimit të familjes, prandaj familja ka randësi më të madhe se ata. „ *Nuk ekziston familja për shkak të shoqërisë, por shoqëria ekziston për shkak të familjes*”.

1.1.Zhvillimi historik i marrëdhënieve familjare

Gjatë zhvillimit të civilizimit njerëzor edhe *familja* i është nënshtruar zhvillimit të vet. Familja ka kaluar nëpër faza të ndryshme të zhvillimit. Ajo ka pasuar transformime të shumta, duke kaluar nga një formë në formën tjetër. Transformimet e tilla janë rezultat i zhvillimit ekonomik dhe ndryshimit të mënyrës së jetesës. Për nga zhvillimi historik, familja ndahet në familjen matriarkale, familja patriarkale dhe familja bashkëkohore.

Familja matriarkale është zhvilluar në fazat më të hershme të zhvillimit shoqëror, në kohën e jetës primitive. Matriarkati kishte për bazë sundimin e gruas në familje. Gruaja kishte pushtet më të gjërë dhe mbi të gjithë anëtarët e familjes përfshirë edhe burrin. Fëmijët llogariteshin nga gjinia e amësisë.

Kjo familje ka ekzistuar deri në kohën e ndryshimeve ekonomike kur burri filloi të jetë bartës kryesor i punëve për mbajtjen e familjes. Në këtë kohë matriarkati zavendësohet me patriarkat. Pushteti i burrit (pater familjasit) mbi familjen e karakterizon familjen patriarkale. Në këtë familje zhvillohet e drejta atërore. Familja bashkëkohore ndryshe e njohur si familja monogame është e karakterizuar nga parimi i barazisë ndërmjet burrit dhe gruas dhe anëtarëve tjerë të familjes. Kjo familje formohet nga martesë e një burri dhe një gruaje.⁵

Marrëdhëniet familjare janë ndryshuar thelbësisht nëpër histori nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm, përfshirë kulturën, fenë, urbanizmin, modernizmin dhe teknologjinë. Këto

⁵ Abdulla Aliu- Haxhi Gashi. E drejta Familjare, fq.4

ndryshime kanë sjellë ndryshime në rolet, strukturën dhe dinamikën e familjes. Në kohën e sotme, marrëdhëniet familjare ndeshen me sfida të reja. Përdorimi i teknologjisë, ndryshimet në normat sociale mbi martesën dhe familjen, si dhe rritja e diversitetit në formën e familjeve (p.sh., familjet monoparentale, familjet homoseksuale) janë thelbësore.⁶

Në këtë kapitull shpjegohet koncepti i familjes dhe zhvillimit historik të saj gjatë shekujve. Fillimisht prezantohet zhvillimi i marrëdhënieve familjare në të drejtën romake, pasi që shumë të drejta a ligje janë të bazuara te e drejta romake.

1.2. Zhvillimi i marrëdhënieve familjare në të drejtën romake

Gjatë historisë së Romës, pas shkatërrimit të rregullimit shoqëror gjentil janë shfaqur dhe zëvendësuar tri forma të familjes: consorciumi, familja patriarkale e agnatëve dhe familja cognate.

- a) Cosnsoriumi- consortium ose kooperativa familjare e agnatëve i prin familjes patriarkale romake, dhe u zhvillua menjëherë pas shpartallimit të gjensit, kur u bë e mundur që pavarësisht të jetojnë dhe të veprojnë grupe prodhuesish më të vogla se sa gjensi i mëparshëm. “Anticum consortium” si e quajti këtë bashkësi Aulo Geli ose „Societas fratrum” si e quajti Gai, e përbënin të afërmit e lire dhe të barabartë agnate.
- b) Familja patriarkale e agnatëve – në familjen e agnatëve, pater familias ishte personi „quo in domo dominium habet”- personi i cili në shtëpi ushtron pushtetin. Patria potestas i përkitste „et in res et in personas” dhe përfshinte : pushtetin e plotë dhe të përhjetshëm mbi gruan e tij dhe gratë e të gjithë bijve të martuar, pushtetin e plotë dhe të përhjetshëm mbi fëmijët e vet, mbi skllevërit që punonin në kuadrin e domusit, pushtetin mbi personat e lirë të cilët përkohësisht gjendeshin në domus në bazë të mancipimit, pushtetin e plotë mbi tokat, mbi veglat e prodhimit , mbi prodhimet e punës dhe mbi pasurinë tjetër në kuadrin e domusit.

⁶ Shorter, E. The Making of the Modern Family,pg.287

- c) Familja cognate- lindi gradualisht dhe u zgjerua me përmirësimin ekonomik dhe personal të pozitës së personave alieni juris , me mbizotërimin e martesës pa manus, si dhe me rendin e ri ligjor të trashëgimit. Familja e kognatëve në kuptim të ngushtë ishte bashkësia e të afërmeve të gjakut që jetonin në ekonomi të përbashkët shtëpiake dhe në kuptim të gjërë ishte një grup i të afërmeve të cilët rridhnin nga gjaku i paraardhësit të përbashkët.⁷

1.3. Zhvillimi i marrëdhënieve familjare në të drejtën mesjetare

Mesjeta ose periudha mesjetare në historinë e Evropës, zgjati afërsisht nga fundi i shekullit të V-të deri në fund të shekullit të XV-të, ngjashëm me periudhën post-klasike të historisë globale. Filloi me rënien e Perandorisë Romake Perëndimore dhe kaloi në Rilindjen dhe Epokën e Zbulimeve. Ndër shtresat e gjera fshatare dominonte familja e madhe patriarkale, ndërsa në rradhët e aristokracisë –familja monogame patriarkale. I zoti i shtëpisë kishte pushtetin mbi anëtarët e familjes. Meshkujt madhorë kishin pushtet mbi meshkujt e mitur, ndërsa burrat kishin pushtet dhe njëfarë të drejte kujdestarie mbi gratë.⁸

Në përgjithësi, familja në periudhën e Mesjetës ishte një njësi e rëndësishme sociale dhe ekonomike, e cila ishte e përcaktuar nga normat kulturore dhe shoqërore të kohës. Familjet ishin shpesh të mëdha dhe të përqëndruara në një vend të vetëm. Për shembull, një familje mund të përfshinte gjyshin, prindërit, fëmijët dhe ndonjë anëtar tjetër të afërt. Gruaja kishte një rol të përcaktuar në kujdesjen e fëmijëve, menaxhimin e shtëpisë dhe punën në bujqësi. Ajo shpesh ishte përgjegjëse për rruajtjen e traditave dhe edukimin e fëmijëve. Burri kishte një rol të rëndësishëm në aspektin ekonomik të familjes. Ai ishte përgjegjës për mbrojtjen e familjes, ushtrinë e vendit dhe administratën.⁹

⁷ Ivo Puhani. E drejta romake, fq.177

⁸ Hilmi Ismaili&Fatmir Sejdiu. Historia e shtetit dhe së drejtës, fq.168

⁹ Jascueline Murray. Family Life in the Middle Ages

1.4.Zhvillimi i marrëdhënieve familjare në të drejtën zakonore shqiptare-Kanuni i Lekë Dukagjinit

Kanuni i Lekë Dukagjinit apo “Kushtetuta” e parë shqiptare mes tjerash ka rregulluar edhe statusin e familjes shqiptare. Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit përcaktimi i familjes ishte:

“Familja asht një të mbledhun gjymtyrësh, të cilët gjallisin nën një kulm, qëllimi i të cillvet asht të shtuemt e gjindes njer mjet të martesës, të mkanbuent e tyne kah zhdrivillimi i shtatit e kah zhvillimi i mendes e i shises.”¹⁰

Pra, sipas kanunit familja është një bashkim gjymtyrësh, të cilët jetojnë në një kulm të përbashkët dhe kanë për qëllim shtimin e gjindjes me anë të martesës. Në Kanunin e Lekë Dukagjinit, familja ka një rol thelbësor dhe një strukturë të përcaktuar. Familja sipas kanunit ishte e përbërë prej gjindjes së shtëpisë, të cilët duke u shtuar krijojnë vëllazëri e gjini e pastaj bashkësia e disa familjeve krijonte fisin, disa fise krijojnë një bajrak ose flamur. Sundimi në shtëpi i takonte më të vjetrit, i cili ishte i zoti i shtëpisë. Në kanun përfshihen edhe shumë rregulla dhe detyrime për zojën e shtëpisë dhe anëtarët e tjerë të familjes.

Është e rëndësishme të theksohet se, megjithëse shumë nga dispozitat e Kanunit të Lekë Dukagjinit janë ende të njohura dhe të respektuara nga disa njerëz në zonat rurale të Shqipërisë, shumica e popullsisë shqiptare sot bazohet në sistemin ligjor të modernizuar dhe të përshtatur me normat ndërkombëtare të drejtësisë dhe të drejtave të njeriut.

1.5.Zhvillimi i marrëdhënieve familjare në të drejtën e shariatit

Familja në secilën fe dhe secilin rregullim social pranohet si gurrëthemel në shoqëri. Edhe feja islame shumë shpesh fokusohet te rëndësia e familjes dhe e konsideron atë si kala mbrojtëse përballë jetës boheme, sepse familja është vendi ku natyra njerëzore mundet ta shprehë veten në mënyrën më të mirë, ku mundet t’i realizojë dhe kthejë në praktikë vlerat e larta si:

¹⁰ Kanuni i Lekë Dukagjinit.Libri i dytë Familja,neni 18

dashuria, respekti, dhembshuria, sakrifica, besnikëria dhe bindja. Afërsisht një e treta e rregullave juridike të Kur'anit kanë të bëjnë me familjen dhe rregullimin e harmonisë së saj. Kurani tregon për ambientin e qetësisë, prehjes shpirtërore, të mëshirës dhe të dashurisë, të cilën e formon sistemi familjar dhe ai e bën këtë sistem një argument prej argumenteve të urtësisë, të fuqisë dhe të madhësisë së Allahut. Sistemi i familjes islame i vendos të drejtat e burrit, gruas, fëmijëve dhe të të afërmeve në një ekuilibër të përsosur dhe këto marrëdhënie nga aspekti juridik dhe moral janë të shpjeguara deri në detajet më të imëta. Ai ushqen tek individit bujarinë, dashurinë dhe sjelljet joegoiste në kuadrin e një familjeje të organizuar mirë. E gjithë kjo ka për qëllim që shoqëria muslimane të ndërtohet mbi themele të shëndosha, pasi qetësia dhe siguria e ofruar nga një familje e stabilizuar ka vlerë të jashtëzakonshme dhe është thelbësore për anëtarët e saj. Pa ekzistencën dhe përkrahjen e një familjeje të shëndoshë nuk mund të realizohet kurrë harmonia në një shoqëri.¹¹

Jeta bashkëshortore është themeli i familjes, kurse familja themeli i bashkësisë njerëzore. Se sa e rëndësishme është, për sa i përket njeriut, familja e formuar si rezultat i martesës, pohohet me këto fjalë në Kur'an: "...ato janë prehje për ju dhe ju jeni prehje për ato..." (Bekare, 187). Ndërsa i dërguari i Zotit porosit: "Fëmija edukohet 20 vjet para lindjes së tij", pra me edukimin e prindërve të tij. Familja është shkolla e parë për edukimin e fëmijëve dhe se fëmija ka nevojë të domosdoshme për dashurinë e saj, ngase ajo e rrit, e frymëzon dhe i jep vullnet atij. Këtë e shohim në rastin kur familja është e shëndoshë, në shpirtin e fëmijës kultivohen ndjenjat e dashurisë, respektit, bashkëpunimit, vullneti i mirë për të tjerët, puna për të mirën e përgjithshme. Feja islame ka për qëllim të krijojë familje të shëndosha në shoqëri. Këto familje të shëndosha nuk mund të shkatërrohen lehtë dhe nuk bien lehtë nën ndikimin e streseve shoqërore dhe morale dhe që mos shkojmë deri te shkatërrimi i familjes prej shtresave ideologjike, të cilat mundohen të depërtojnë në familjet tona, ne duhet ta forcojmë strukturën familjare.

¹¹ Hurshid Ahmed, Jeta familjare në Islam, fq.16

2.MARRËDHËNIET JURIDIKE-PERSONALE NË FAMILJE

2.1. Jeta familjare

Familja si bashkësi sociale e humane, si pjesë themelore e një shoqërie, i ka specifikat e veta që detyrimisht i nënshtrohet edhe normave juridike të funksionimit. Siç është cek edhe këtu, ajo më së paku, përbëhet nga prindërit,(e ëma dhe i ati), si dhe së paku, nga një fëmijë. Varësisht nga psikologjia e marrëdhënieve interpersonalë në familje, varet edhe funksionimi normal i familjes. Varësisht nga ajo se cilit grup i takon korniza mentale psiqike e prindërve, pra a janë me përcaktime autoritare, liberale-demokratike, gjegjësisht, komunikimi interpersonal a është i zhvilluar, a janë *introvert* apo *ekstrovert*, me *open mind* të zhvilluar apo jo, determinohen edhe marrëdhëniet interpersonalë. Megjithatë marrëdhëniet juridike-personale dalin nga përcaktimet ligjore që i vlerësojnë këto interaksione personale në familje, vendimet e gjykatave, gjatë procedimit të kontesteve, për shembull, në fazën e shkurorëzimit, duhet t'i marrin parasysh këto raporte të psikologjisë interpersonalë. Sipas nenit 8 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut:

1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korespondencës së tij”,

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.¹²

Një jetë familjare paraqet një përbërje komplekse të marrëdhënieve, përgjegjësisë, dhe dinamikave mes anëtarëve të një familjeje. Në thelb, jeta familjare është një sistem social dhe

¹² Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut.

emocional që përfshin një grup individësh që jetojnë bashkë në një mjedis dhe ndajnë lidhje të ngushta emocionale, përgjegjësi dhe përvoja të përbashkëta të jetës.

Në një shembull të zakonshëm të një jete familjare, kjo përfshin prindërit dhe fëmijët e tyre. Prindërit kujdesen për rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve, duke ofruar kujdes emocional dhe fizik, edukim dhe udhëzim. Fëmijët, nga ana tjetër, zhvillojnë marrëdhënie me prindërit e tyre dhe mësojnë vlera dhe norma shoqërore nga familja e tyre. Kjo është një dinamikë thelbësore në rritjen dhe formimin e individëve. Megjithatë, struktura e një jete familjare mund të jetë shumë më komplekse dhe e ndryshme. Për shembull, disa familje përfshijnë edhe gjyshërit, kushërinjtë, motrat, vëllezërit, dhe të tjerë anëtarë të afërt të familjes. Struktura dhe dinamika e një jete familjare ndikohet nga shumë faktorë, përfshirë kulturën, traditat, besimet dhe vlerat që familja përfaqëson. Familjet ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme në ndryshimet e epokave dhe shoqërisë. Kujdesi për të mbajtur një jete familjare të shëndetshme dhe të lumtur është një sfidë e vazhdueshme dhe kërkon angazhim të vazhdueshëm dhe përpjekje nga të gjithë anëtarët e familjes.

2.2. Funksionet e familjes

Me kalimin e kohës, funksionet e familjes kanë filluar të ndryshojnë, të hiqen ose të zgjerohen me shfaqjen e atyre të reja. Kjo nuk është vetëm për funksionet brenda qelizës familjare, por edhe për funksionet e familjes si një koncept abstrakt: toleranca po rritet drejt shkëlqes së disa roleve sociale, ndërsa të tjerët po fitojnë gjithnjë e më shumë forcë. Disa funksione të familjes shkojnë në sfond, të tjerët dalin të jenë më të rëndësishme. Megjithatë, funksionet fundamentale të familjes nuk kanë pësuar ndryshime thelbësore dhe kanë mbetur thuajse të pandryshuara edhe sot e kësaj dite. Si funksione që më së shpeshti përmenden janë:

1.Funksioni riprodhues – është një nga funksionet themelore të familjes në të gjitha etapat e zhvillimit të saj historiko-shoqëror. Ai rrjedh nga ligji natyror për vazhdimin e racës njerëzore si pasojë e marrëdhënieve seksuale midis burrit dhe gruas. Funksioni riprodhues është i

rëndësishëm jo vetëm për familjen, por edhe për shoqërinë, pasi që lindja e fëmijëve e rinovon popullsinë. Duhet cekur se funksioni reprodktiv i familjes ka ndryshuar nëpër kohë dhe vazhdon të pasojë ndryshime të ndryshme. Këto ndryshime përfshijnë shfrytëzimin e teknologjisë së riprodhimit, strukturat familjare të ndryshme dhe ndryshimet në role dhe përgjegjësitë gjinore.

2. Funksioni ekonomik- është një nga ato funksione të familjes që ka pësuar një transformim të rëndësishëm për shkak të evolucionit të familjes. Në fillim, kur marrëdhëniet e prodhimit nuk ishin zhvilluar ende sa duhet, nevojat familjare plotësoheshin brenda bashkësisë familjare. Për këtë arsye, familja nuk paraqiste vetëm bashkësi biologjike por edhe prodhuese. Në periudhën e kapitalizmit të hershëm, karakteristike është edhe përfshirja e fëmijëve në procesin e prodhimit. Në kushtet bashkëkohore të jetesës, funksioni ekonomik humb kuptimin e tij për familjen, e cila nga një bashkësi shoqërore prodhuese shndërohet në një bashkësi shoqërore konsumuese.¹³

3.Funksioni i rritjes dhe edukimit- nënkupton të drejtën dhe detyrën e familjes që të kujdeset për edukimin e drejtë të fëmijëve dhe arsimimin e tyre në pajtim me dëshirat dhe prirjet e tyre. Familja gjatë gjithë zhvillimit të saj ka qenë celula e rritjes dhe edukimit të njeriut. Si rregull çdo anëtar i familjes, njohuritë e para dhe edukimin e merr nga familja në të cilën lindën dhe jeton, prandaj roli dhe funksioni i familjes është mjaft i rëndësishëm. Edukimi dhe arsimimi i fëmijëve nuk është vetëm dëshirë por edhe detyrim i prindërve. E drejta për rritje dhe edukim të fëmijëve parashihet në shumë konventa ndërkombëtare.¹⁴ Gjithashtu edhe me Ligjin për familjen të RMV, është e drejta e rritjes dhe edukimit ku në nenin 8 thuhet “ prindërit ndaj fëmijëve të tyre kanë të drejta dhe detyrime (të drejtën prindërore). Marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve bazohen në të drejtat dhe detyrimet e prindërve për t’u kujdesur për rritjen, mbajtjen, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të tyre dhe për të zhvilluar aftësitë dhe

¹³ Emine Zendeli,Arta selmani-Bakui,Dejan,Mickoviq,Angel Ristov .E drejta familjare ,fq.96

¹⁴ Abdulla Aliu-Haxhi Gashi. E drejta Familjare, fq.53

zakonet e tyre punuese”.¹⁵ Prandaj mund të themi se funksioni i rritjes dhe edukimit të familjes është një përgjegjësi e familjes, i cili është i rregulluar dhe mbrojtur me ligj.

4.Funksioni mbrojtës- familja ofron mbrojtje dhe siguri për anëtarët e saj. Përmes lidhjeve të ngushta dhe përkujdesjes së ndërsjellë, anëtarët e familjes ndihen të sigurtë dhe të mbrojtur nga sfidat e jashtme. Funksioni mbrojtës i familjes në të kaluarën ishte një ndër funksionet më të rëndësishme dhe përfshinte mbrojtjen fizike, ekonomike, mbrojtjen juridike, mbrojtjen mjekësore etj. Mirëpo, me zhvillimin e shoqërisë këto funksione humbin rëndësinë. Kështu, funksioni mbrojtës i familjes në kuptimin e mbrojtjes fizike dhe psikike, sot është detyrë dhe përgjegjësi e shoqërisë, përkatësisht shteti merr masa për mbrojtjen dhe sigurinë e qytetarëve të vet. Megjithatë, në familje kanë mbetur disa aktivitete mbrojtëse si : përkujdesja ekonomike, përkujdesja për mbrojtjen e interesave të anëtarve të familjes etj.

5.Funksioni socializues- është një nga funksionet më të vjetra të familjes. Përmes edukimit nga ana e prindërve foshnja përgatitet për jetë në shoqëri. Njihet me nocionet dhe pikëpamjet më të përgjithshme për shoqërinë, normat dhe vlerat si dhe marrëdhëniet me atë. Përmes shoqërizimit i pranon formalitetet kulturore të bashkësisë në të cilën lind dhe rritet. Funksioni socializues është i rëndësishëm për formimin e individëve dhe shoqërisë në tërësi. Familja luan një rol të madh në formimin e personalitetit, vlerave dhe sjelljeve shoqërore të anëtarve të saj. Në familje fëmijët zhvillojnë aftësitë sociale dhe komunikuese, duke komunikuar me prindërit, vëllezërit dhe anëtarët e tjerë. Familja është një mjedis ku anëtarët mësojnë si të përshtaten me rrethanat shoqërore, aty mësohet disiplina dhe respekti, trashëgojnë traditat dhe identiteti kulturor e historik.

¹⁵ Ligji për familjen, neni 8

2.3. E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare

E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare është një pjesë e të drejtave të njeriut dhe është mbrojtur nga shumë instrumente ndërkombëtare të drejtave të njeriut, si dhe nga ligjet kombëtare të shumë vendeve. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, janë dy dokumente kyçe ndërkombëtare që përcaktojnë këtë të drejtë. Në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, në nenin 12 thuhet: “Askush nuk duhet të ndërhyjë në jetën private familjare, në shtëpinë e tij dhe në korespondencën e tij pa ndonjë arsye ligjore”.¹⁶ Në të njëjtën mënyrë, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në Neni 8, thekson se “Çdo person ka të drejtë në respektimin e jetës së tij private dhe familjare, të shtëpisë së tij dhe të korespondencës së tij”.

Zhvillimet e teknologjisë, përdorimi i internetit dhe zhvillimet e tjera kanë sjellë sfida të reja për këtë të drejtë, duke e bërë aktualizimin dhe zbatimin e saj një çështje të rëndësishme në shoqëritë moderne. Mbrojtja e jetës private dhe familjare përfshin të drejtat për privatësi, mbrojtjen nga shpifja, përdorimi i të dhënave personale etj. Këto të drejta janë thelbësore për rruajtjen e lirive individuale dhe integritetit njerëzor. Përveç Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, shumë vende kanë inkorporuar mbrojtjen e jetës private dhe familjare në kushtetutat e tyre dhe ligjet e brendshme. Edhe në RMV kjo e drejtë është e mbrojtur me kushtetutë ku sipas nenit 25 thuhet: “Çdo qytetari i garantohet respektimi dhe mbrojtja e privatësisë së jetës të tij personale dhe familjare, e dinjitetit dhe e autoritetit”. Poashtu sipas nenit 26 “Garantohet paprekshmëria e shtëpisë. E drejta e paprekshmërisë së shtëpisë mund të kufizohet vetëm me vendim gjyqësor, kur është në pyetje zbulimi ose pengimi i veprave penale ose mbrojtja e shëndetit të njerëzve”.¹⁷ Gjithashtu, ka rëndësi të përmendet se kjo e drejtë nuk është absolute dhe mund të nënshtrohet kufizimeve në rastet kur këto kufizime janë të nevojshme në shoqërinë demokratike për të mbrojtur interesa të tjera ligjore, të tilla si siguria publike, mbrojtja e të

¹⁶ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, (10 dhjetor 1948), neni 12

¹⁷ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, neni 25,26

drejtave të tjera të njeriut ose parandalimi i krimit. Mekanizmat e pavarur të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, siç janë ombudsmeni dhe gjykatat, luajnë një rol kyç në zbatimin dhe mbrojtjen e kësaj të drejte të rëndësishme.

2.4. Të drejtat dhe detyrimet familjare

Aty ku bashkëjetojnë njerëzit domosdo nevojiten rregulla e norma për të cilat do të bien dakord ata. Familja si bërthama e shoqërisë nuk mund të paramendohet të ofrojë atë që pritet prej saj, në qoftë se anëtarët e saj nuk i plotësojnë disa detyra ndaj të tjerëve. Detyrat dhe të drejtat janë reciproke, të ndërsjella. Detyra e njërit është e drejtë e tjetrit dhe anasjelltas. Detyrat dhe përgjegjësitë në familje përfshijnë detyrat që bashkëshortët i kanë ndaj njëri-tjetrit, detyrat që prindërit i kanë ndaj fëmijëve të tyre, detyrat që fëmijët i kanë ndaj prindërve të tyre, si dhe detyrat që fëmijët i kanë ndaj njëri-tjetrit. Anëtarët e familjes janë të barabartë në të gjitha pjesët e të drejtës familjare. Në të drejtën martesore, burri dhe gruaja janë të barabartë në të drejtat dhe detyrimet e tyre si bashkëshortë, në të drejtën prindërore si prindërit kanë të drejta dhe detyrime etj.

Të drejtat dhe detyrat e prindërve ndaj fëmijëve janë: vënia e emrit personal që i takon çdo fëmije të lindur; ruajtja dhe mirërritja e fëmijëve që nënkupton rruajtjen e tyre nga çfardo rreziku që mund t'u kanoset si dhe rruajtjen e shëndetit dhe mjekimin e fëmijëve; edukimi dhe arsimimi që paraqet të drejtën dhe detyrimin që t'i edukojnë fëmijët dhe të përkujdesen për shkollimin e tyre. Mbajtja e fëmijëve nënkupton përgjegjësinë e prindërve që t'i sigurojnë fëmijës të mirat materiale për jetë; përfaqësimi i fëmijës nënkupton kryerjen e veprimeve juridike dhe punëve tjera, (punë për të cilat nevojitet zotësia e veprimit) nga ana e prindit në emër dhe për llogari të fëmijës; administrimi i pasurisë së fëmijëve që nënkupton ndërmarrjen e masave dhe veprimeve të ndryshme me qëllim të ruajtjes dhe shtimit të pasurisë së fëmijës.

Të drejtat e fëmijëve ndaj prindërve në të vërtetë janë detyrimet e prindërve ndaj fëmijëve. Prindërit dhe fëmijët detyrohen në ndihmë dhe konsideratë të ndërsjellët gjatë gjithë jetës.

Detyrimet e fëmijëve janë detyrime ligjore dhe detyrime morale. Fëmijët kanë detyrë ligjore për t'i mbajtur prindërit. Mbajtja e prindërve nënkupton sigurimin e të gjitha të mirave materiale për jetesë. Detyrimet morale nënkuptojnë mirësjelljen e fëmijëve ndaj prindërve. Si detyrime të tilla janë: dëgjimi i prindërve, këshillimi me prindër, respektimi i prindërve, ngushëllimi i tyre etj.¹⁸

2.5.Tendencat bashkëkohore të familjes dhe roli i të drejtës familjare

Proceset dinamike të zhvillimit të hovshëm të modernitetit, globalizimit, inovacionet teknologjike dhe komunikimet masive kanë ndikuar fuqishëm edhe në familje. Sa më shumë që këto procese na hapën mundësi dhe perspektiva të reja, poashtu na ekspozuan ndaj rreziqeve dhe anktheve të reja, veçanërisht në sferën e jetës familjare. Tendencat bashkëkohore të familjes kanë ndryshuar ndjeshëm në dekadat e fundit për shkak të ndryshimeve të shumta shoqërore, ekonomike dhe kulturore.

Në fazën e tranzicionit, në të cilën aktualisht po kalojmë, familja po përballlet me disa situata katoike të jetës shoqërore (vetë-vrasjet, prostitucioni, dhuna familjare, korrupsioni, krimi i organizuar, nepotizmi). Përderisa, në shoqërinë tradicionale agjenci ekskluzive e socializmit ishte familja dhe deri diku shkolla, në shoqërinë (post)moderne hapësirë të madhe kanë mjetet e komunikimit, grupet e bashkëmoshatarëve, vendi i punës dhe institucionet shoqërore, politike,kulturore, fetare etj. Kjo është arsyeja pse ne besojmë se institucioni i familjes, në periudhën e tranzicionit nëpër të cilin po kalon shoqëria jonë, është i ekspozuar ndaj transformimeve dhe sfidave të mëdha, të cilat na i sjell procesi universal i globalizmit.¹⁹ Këtu janë disa nga “sfidat” apo tendencat ku përfshihet dhe roli i të drejtës familjare në shoqërinë bashkëkohore:

¹⁸ Abdulla Aliu-Haxhi Gashi. E drejta familjare, fq.232

¹⁹ Anthony Giddens ,*Sociologjia*, fq. 396

- a) Ndryshimi i strukturës së familjes - në shoqëritë bashkëkohore, struktura e familjes ka ndryshuar ndjeshëm. Familjet tradicionale, ku babai, nëna dhe fëmijët jetojnë së bashku, është zëvendësuar nga një gamë e gjerë e modeleve të familjes, duke përfshirë familjet monoparentale ose të rritura me prindër të ndarë, shtimi i shkurorëzimeve dhe familjeve të ndara, shtimi i numrit të bashkësive jashtëmartesore etj.
- b) Ndikimi i barazisë gjinore - Në ditët e sotme, barazia gjinore është një temë kryesore në familje. Pozita, përgjegjësitë në mes burrit dhe gruas janë të barabarta.
- c) Prania e homoseksualëve dhe personave transgjinorë – Në shumë jurisdiksione martesat e personave të së njëjtës gjini janë bërë legale. Kjo ka sjellë ndryshime në të drejtën familjare në lidhje me adoptimin, ndarjen e pasurisë dhe të drejtat prindërore të këtyre personave.
- d) Ndikimi i teknologjisë – Teknologjia ka ndryshuar mënyrën se si anëtarët e familjes komunikojnë, ndajnë informacione dhe shpenzojnë kohën së bashku.
- e) Shkalla e ulët e natalitetit – Rënia e trendit të lindjeve që arsyetohet me arsimimin dhe emancipimin e grave, kushteve të vështira ekonomike, planifikimit familjar, mos ekzistimi i politikave për shtim të natalitetit etj.
- f) Bashkëjetesa - Në kohen bashkëkohore paraqitet si një alternativë apo sfidë e martesës konvencionale, ku partnerët rrojnë së bashku në marrëdhënie me njëri tjetrin, pa qenë të martuar .

Të gjitha këto ndryshime kanë ndikuar thellësisht në disa aspekte të teorive dhe praktikave të së drejtës familjare. Këto ndryshime kanë sjellë nevojën për adaptim dhe riformulim të ligjeve dhe politikave që rregullojnë marrëdhëniet familjare. Kështu, ndryshimet në strukturën e familjes kanë sjellë nevojën për rishikim të të drejtave dhe përgjegjësisve të prindërve, duke përfshirë ndarjen e përgjegjësisve në rast të shkurorëzimit dhe bashkëjetesës së prindërve të ndarë. Ndryshimet në kuptimin e barazisë gjinore kanë ndikuar në mënyrë se si ligjet e familjes trajtojnë çështjet e martesës, ndarjen e pronës dhe kujdesit të fëmijëve. Edhe legalizimi i martesave të homoseksualëve ka sjellë një rishikim të plotë të ligjeve familjare. Ligjet poashtu

duhet të përshtaten për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe të rriturve në botën digjitale.

3.SHKURORËZIMI

3.1. Nocioni i shkurorëzimit dhe shkaqet kryesore për shkurorëzim

Më dëshirën e njërit bashkëshort, apo me kërkesën e të dyve, fillon procedura e shkurorëzimit të martesës. Përmes kësaj kërkeje parashtrohen edhe shkaqet që kanë shty deri tek ky vendim. Kryesisht kjo procedurë i nënshtrohet vendimit të gjykatave dhe qëndrimit të tyre ndaj kërkesave. Pra, shkurorëzimi përkufizohet si zgjidhje e martesës së vlefshme, gjatë jetës së bashkëshortëve për shkaqe të parashikuara me ligj dhe me procedurë gjyqësore. Në disa nga nenet vijuese të Ligjit për familje të RMV, në mënyrë taksative ceket forma dhe mënyra e kërkesës për shkurorëzim të martesës. Neni 39 parasheh që martesa shkurorëzohet me pajtueshmëri të përbashkët të bashkëshortëve. Poqese bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët të mitur, ose fëmijë të ritur mbi të cilët është vazhduar e drejta prindore, pra kujdesi prindor, duhet të dorëzohet marrëveshja për mënyrën e zbatimit të drejtave prindërore dhe obligimeve, si dhe për kujdesin dhe edukimin e fëmijëve.

Sipas nenit 40, martesa mund të shkurorëzohet me kërkesë të njërit nga bashkëshortët poqese marrëdhëniet bashkëshortore janë çrregulluar deri në shkallën kur bashkëjetesa bëhet e padurueshme. Kurse sipas nenit 41, të këtij ligji, njëri nga bashkëshortët, mund të kërkojë shkurorëzim, poqese bashkësia martesore nuk funksionon mbi një vjet. Nga përkufizimi i shkurorëzimit mund t'i nxjerrim disa veçori të shkurorëzimit: ekzistimi i martesës së vlefshme, shkurorëzimi bëhet sa të jenë gjallë bashkëshortët, shkurorëzimi bëhet për shkaqe të parashikuara me ligj, shkurorëzimi bëhet në procedurë gjyqësore.

Mënyra e përcaktimit të shkaqeve të shkurorëzimit dallon nga legjislacionet e ndryshme dhe kjo varësisht se cilin sistem e kanë përvetësuar. Legjislacioni ynë familjar parashikon tri arsye

për të cilat mund të shkurorëzohet martesë: 1) me pëlqimin e ndërsjellë të bashkëshortëve për shkurorëzimin e martesës, 2) me kërkesë të njërit prej bashkëshortëve, nëse marrëdhëniet martesore janë tronditur deri në atë masë, sa që jeta e përbashkët është bërë e padurueshme dhe 3) me pushimin faktik të martesës.²⁰

3.2.Pasojat e shkurorëzimit në marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve

Kur përplasja e partnerëve i ka kaluar kufijtë e mundshëm të mirëkuptimit, atëherë është më e udhës që secili “të shkojë në punë të vet”. Po kush i paguan pasojat e shkurorëzimit? Pasojat e shkurorëzimit më së tepërmi ndihen dhe vërehen tek familjet që kanë fëmijë, veçanërisht kur ata janë të mitur. Gjatë marrëdhënieve konfliktuoze me rrezikshmëri të lartë, më së shumti pëson fëmija, për shkak të traumatizimit të tyre psikik, por në të shumtën e rasteve edhe të traumatizimit të tyre fizik, përmes llojeve të ndryshme të dhunës, nga njeri apo nga që të dy prindërit. Shpeshëherë, prindi për ta përvetësuar animin e fëmijës nga ai, simulon raste të ndryshme kundër prindit tjetër për ta arsyetuar veprimin e vet kundrejt prindit tjetër.

Pasojat e ndarjes së prindërve mund të ndjehen ndryshe nga fëmijët në varësi të faktorëve të shumtë, përfshirë moshën e tyre, mënyrën se si është kryer shkurorëzimi dhe mbështetjen që ata marrin nga prindërit e tyre.

Disa nga sfidat emocionale që fëmijët e grupmoshës së ndryshme mund të përjetojnë nëpër faza të ndryshme zhvillimore:

- **Fëmijët e vegjël** e kanë më të vështirë të kuptojnë arsyet se pse duhet të ndahen mes dy shtëpive. Mund të kenë frikë se prindërit e tyre një ditë mund që mos t’i duan edhe ata.
- **Fëmijët e shkollës fillore** përjetojnë një vetëmbyllje. Mendojnë se faji i ndarjes është i tyre. Se ata kanë bërë diçka gabim ose janë sjellë keq.

²⁰ Emine Zendeli,Arta selmani-Bakiu,Dejan,Mickoviq,Angel Ristov .E drejta familjare ,fq.162

- **Adoleshentët** mund të bëhen shumë agresiv për shkurorëzimin dhe ndryshimet që ai shkakton. Ata mund ta fajësojnë njërin prind për prishjen e martesës ose mund të ndjejnë urrejtje për të dy prindërit për tronditjet dhe ndryshimet e mëdha në familje.²¹

Është e rëndësishme të kuptohet se reagimi i secilit fëmijë ndaj shkurorëzimit është ndryshe dhe rrethanat individuale luajnë rol të rëndësishëm në përcaktimin e reagimeve të tyre. Çdo fëmijë dhe familje është unike me forca dhe dobësi të ndryshme, personalitete dhe temperament të ndryshëm, shkallë të ndryshme burimesh shoqërore, emocionale dhe ekonomike, si dhe situata të ndryshme familjare para shkurorëzimit. Pavarësisht këtyre dallimeve, shkurorëzimi është treguar se zvogëlon aftësinë e një fëmije në të ardhmen në të gjitha fushat e jetës, përfshirë marrëdhëniet familjare, arsimimin, mirëqenien emocionale dhe aftësinë për të fituar pushtet në të ardhmen. Një shqyrtim i literaturës i kryer në Mbretërinë e Bashkuar zbuloi se "përkundër se fëmijët janë në rrezik të shtuar për pasojat e këqija pas shkatërimit të familjes dhe që pasojat negative mund të vazhdojnë në moshën e rritur, ndryshimi mes fëmijëve nga familjet e integruara dhe atyre që nuk janë të integruara është i vogël dhe shumica e fëmijëve nuk do të preken negativisht në afat të gjatë."²² Megjithatë, në rrethana të caktuara, një fëmijë mund të ketë ndjenjën e lehtësimit nga ndarja, nëse një shkurorëzim do të thotë më pak debate dhe më pak stres, pasi konfliktet e vazhdueshme midis prindërve krijojnë një mjedis të tensionuar dhe të papërshtatshëm për fëmijët.

Në përgjithësi, pasojat e shkurorëzimit janë të dukshme dhe është e rëndësishme që prindërit të kenë kujdes dhe të ofrojnë mbështetje emocionale të mjaftueshme për fëmijët gjatë këtij procesi dhe në raste më të rënda të konsultohen me profesionistë për të menaxhuar stresin dhe traumën që mund të shkaktojë shkurorëzimi.

²¹ The Psychological Effects of Divorce on Children - <https://www.verywellfamily.com>

²² A.mooney, C.Oliver, MarjorieA.Smith. Impact of Family Breakdown on children's Well-being

3.3. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve gjatë procedurës së shkurorëzimit

Bashkëshortët mund të kërkojnë shkurorëzim kur marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht ose në mënyrë të vazhdueshme, ose kur për shkaqe të tjera martesë është zgjidhur në mënyrë të pakthyeshme. Së bashku me propozimin për shkurorëzim me marrëveshje të dyanshme, bashkëshortët janë të detyruar të parashtrojnë marrëveshjen me shkrim për përkujdesje, edukim dhe ushqim të fëmijëve të tyre të përbashkët. Në kontestet martesore ku janë të përfshirë edhe fëmijët gjykata dhe institucionet e tjera janë të detyruar të ofrojnë mbrojtje për fëmijët, që përballen me manipulimin e fëmijëve nga njëri ose prindi tjetër, ndryshimin e ambientit familjar, ndryshimin e vendbanimit, ambienteve sociale apo shkollës, martesën e prindërve të shkurorëzuar pas ndarjes etj.

Sa herë që një fëmijë të përfshihet në çfarëdo lloji cilësie në procedurë gjyqësore, angazhimi i Qendrës për Punë Sociale është i detyrueshëm. Sipas Keshillit të Evropës “ situata në të cilën ndodhen fëmijët në një shtet është shpesh një tregues i gjendjes së gjithëmbarshme për sa i përket respektimit të të drejtave të njeriut në atë shtet, veçanërisht ngase fëmijët përbëjnë një prej grupeve më të ndjeshme të shoqërisë” .

Mbrojtja e të drejtave të fëmijës gjatë procedurës së shkurorëzimit duhet të jetë një prioritet i rëndësishëm. Gjykata dhe Qendra për Punë Sociale duhet të jenë në bashkëpunim të vazhdueshëm për marrjen e vendimit mbi kujdesin e fëmijëve, sepse qëllimi është të sigurohet mirëqenia dhe zhvillimi i përshtatshëm i fëmijëve. Secili fëmijë i cili ka aritur moshën 10 vjeçare ka të drejtë të shpreh mendimin e tij dhe të dëgjohet nga ana e organeve kompetente në rastet kur vendoset për të drejtat dhe interesat e tij. Për fëmijët më të vegjël, vendimin se a do të dëgjohet dhe a do të merren parasysh qëndrimet e tij e merr gjykata, në pajtueshmëri me moshën dhe nivelin e tij të pjekurisë.

3.4. Mediacioni si alternativë e zgjidhjes së kontestit

Mediacioni është mjet i përshtatshëm për zgjidhjen e kontesteve që përfshin një person të pavarur, të njohur si mediator, për të ndihmuar palët e konfliktit në arritjen e një marrëveshjeje të përbashkët. Është një mënyrë paqësore për të zgjidhur mosmarrëveshjet dhe konfliktet në vend që palët të shkojnë në gjykatë.

Në legjislacionet më të përsosura, problemet që janë pjesë e kontesteve familjare zgjidhen përmes institutit të mediacionit. Zbatimi i kësaj forme e anashkalon gjyqin dhe e lehtëson zgjidhjen e kontestit. Sipas Ligjit për mediacion, në nenin 1, paragrafi 2 në mënyrë taksative janë të numëruar të gjitha llojet e kontesteve që mund të zgjidhen përmes mediacionit, repektivisht cilët konteste janë më diskutabile edhe atë: kontestet pronëso-ro-juridike, kontestet familjare, të punës, kontestet tregtare, konsumatore, kontestet e sigurimeve, konteste nga fusha e arsimit, mbrojtja e ambientit jetësor, kontestet në lidhje me diskriminimin, si dhe konteste tjera ku mediacioni i përgjigjet natyrës së kontesteve dhe mund të ndihmojë për zgjidhjen e tyre.²³

Mediacioni në kontestet familjare është një zgjidhje më e përshtatshme e çështjeve. Kjo përfshin mosmarrëveshjet mes çifteve të shkurorëzuara , çështjet e kujdesit për fëmijët, ndarja e pronës dhe çështje tjera të ngjashme.

Rastet familjare gjithmonë kanë qenë më specifike, stresuese dhe më të rënda, sidomos në procedurat gjyqësore të shkurorëzimit të bashkëshortëve që kanë fëmijë. Prandaj mediacioni është më se i nevojshëm të përfshihet sa më shumë në procedura të tilla për arsye se paraqet një zgjidhje më relaksuese të këtyre kontesteve dhe ndihmon në mbrojtjen e fëmijëve nga situatat konfliktuoze të cilat mund të paraqiten në gjykatë. Mediacioni luan rol të rëndësishëm edhe në zgjidhjen e konflikteve eventuale midis prindërve gjatë ushtrimit të së drejtës prindërore, duke ndihmuar prindërit që me marrëveshje të arrijnë të ushtrojnë të drejtat e tyre prindërore.

²³ Ligji për mediacion (Gayeta zyrtare e RM, nr.138/09)

Mbrojtësit e mediacionit si formë e zgjidhjes së kontesteve thonë që “ Procedura juridike ndërton mure, ndërsa mediacioni apo ndërmjetësimi ndërton ura “.

Mediacioni si një institut profesional i pavarur garanton zgjidhje që është në interes të të gjitha palëve të përfshira, ndihmon në arritjen e një marrëveshjeje më të qëndrueshme dhe më të pranueshme për të dyja palët, është zakonisht më i lirë se palët të shkojnë në gjykatë, ku shpenzimet janë më të mëdha. Gjithashtu mediacioni zgjidhet më shpejtë se procedurat gjyqësore, që shpëton kohë dhe energji të të gjithë përfshirësit.

Suksesit të mediacionit i nevojiten mediatorë të aftë dhe kompetent, që kanë përvojë në menaxhimin e konflikteve dhe mund të ofrojnë këshilla për zgjidhjen, pasi që në disa raste palët mund të jenë aq të papajtueshëm ose konflikti ka natyrë shumë të rëndë, sa që mediacioni mund të mos sjellë rezultate. Duke u bazuar në rolin që ka mediacioni dhe rëndësinë e tij, shumë vende sot e aplikojnë këtë formë të zgjidhjes alternative të kontesteve, duke miratuar ligje që përcaktojnë dhe definojnë këtë veprimtari përmes akteve ligjore. P.sh. në Norvegji , ndjekja me ndërmjetësues e çështjeve familjare është edhe e detyruar.²⁴

Në të kaluarën mediacioni apo ndërmjetësimi është praktikuar në të drejtën zakonore shqiptare si në Kanunin e Lekë Dukagjinit, Kanunin e Arbërit dhe në të drejtën zakonore Islame (Sheriatit). Në RMV, mediacioni është një institut i ri juridik. Edhe pse RMV ka ligj për mediacionin, zbatimi i tij, është nën nivelin e duhur. Është më se e nevojshme themelimi i sa më shumë Qendrave për mediacion, të cilat nëpërmjet aktiviteteve të tyre në harmoni me Ligjin për mediacion, të njoftojnë sa më shumë opinionin publik, për mundësitë që ofron mediacioni në zgjidhjet e kontesteve, qëndrueshmërinë dhe përfitimet afatgjate të palëve. Esenca dhe filozofia e mediacionit qëndron në faktin se mosmarrëveshjet mes njerëzve janë pjesë e pandashme e përditshmërise dhe këto mosmarrëveshje burojnë si pasojë e keqkuptimeve. Prandaj, me rëndësi është se si t'i trajtojmë ato dhe për të arritur këtë , nevojitet një person që ndërmjetëson dhe bëhet si ideator në zgjidhjen e kontesteve mes tyre.

²⁴ Goverment.no; National Mediation Service

3.5. E drejta prindërore pas shkurorëzimit

E drejta prindërore është pjesë e të drejtës pozitive familjare e cila i rregullon marrëdhëniet në mes prindërve dhe fëmijëve si dhe personave të tjerë në gjini. Të drejtën prindërore e përbëjnë përgjegjësitë, të drejtat dhe obligimet e prindërve që të kujdesen për personalitetin, të drejtat dhe interesat e fëmijëve të tyre të mitur, si dhe fëmijëve të cilëve u është vazhduar ushtrimi i të drejtës prindërore. Ligji për familje, në mënyrë shprehimore dhe taksative i parashikon të drejtat dhe obligimet e prindërve dhe fëmijëve edhe atë: 1) e drejta dhe obligimi i fëmijëve që t'i mbajnë fëmijët e mitur, të kujdesen për jetën dhe shëndetin e tyre, t'i përgatisin për jetë dhe punë të pavarur, të kujdesen për edukimin, shkollimin dhe aftësimin profesional të tyre(neni 46) ; 2) e drejta e fëmijëve të mitur që të jetojnë me prindërit e tyre (neni 47); 3) e drejta dhe obligimi i prindërve që t'i përfaqësojnë fëmijët e tyre(neni 48).²⁵

Është detyrë dhe e drejtë e prindërve që të kujdesen për mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve. Meqë objekt shqyrtimi është e drejta prindërore pas shkurorëzimit të martesës në RMV, rreth obligimit të prindërve ndaj fëmijëve do t'i përmendi edhe :

- 1.Të drejtën dhe obligimin e prindërve ndaj personalitetit të fëmijës/fëmijëve; dhe
- 2.Të drejtat dhe obligimet e prindërve ndaj pasurisë së fëmijës.

Legjislacioni aktual i RMV, këtë të drejtë e rregullon në suaza të Ligjit për familje. Në pjesën e parë të këtij ligji në dispozitat e përgjithshme neni 1. parasheh që me këtë ligj të rregullohen: martesa dhe familja, marrëdhëniet në martesë dhe familje, format të caktuara të mbrojtjes së veçantë të familjes, dhuna familjare, adoptimi(birësimi), kujdestaria, mbajtje (ushqimi), si dhe procedurat gjyqësore gjatë kontesteve bashkëshortore dhe familjare dhe veprimi i shqiptimit të masës së përkohëshme për mbrojtje nga dhuna.²⁶

Në kapitullin e IV ku flitet për kryerjen e të drejtës prindërore, në nenin 80 thuhet: Me aktgjykim me të cilin bëhet shkurorëzimi, gjykata do të vendos për ruajtjen, edukimin dhe

²⁵ Emine Zendeli, Arta Selmani-Bakiu, Dejan Micković, Angel Ristov. E drejta familjare ,fq.220

²⁶ Ligji për familjen(Gazeta zyrtare e RM-së)

përkujdesjen e fëmijëve të përbashkët. Në qoftëse prindërit nuk janë dakorduar (marrë vesh) për këtë, ose marrëveshja e tyre nuk i konvenon interesave të fëmijëve, gjykata pasi të marr mendimin e Qendrës për punë sociale dhe pasi t'i shqyrtojë të gjitha rrethanat, do të vendos për qëndrimin e fëmijëve për kujdesje dhe edukim tek njëri prind, ose disa ditë do të mbetet tek nëna, kurse disa ditë tek babai, ose të gjithë do t'i besohen ndonjë personi të tretë, gjegjësisht ndonjë institucioni.²⁷ Prindit të cilit nuk i është dhënë besimi për përkujdesje, ka të drejtë të mbajë lidhje dhe kontakte personale të drejtëpërdrejta me ta, poqese gjykata nuk vendos ndryshe, në përputhje me interesat e fëmijëve. Gjykata, me kërkesë të njërit bashkëshort të shkurorëzuar ose me kërkesë të Qendrës për punë sociale, do ta ndërrojë vendimin për përkujdesje dhe edukim të fëmijëve si dhe për marrëdhëniet e bashkëshortëve të shkurorëzuar ndaj fëmijëve të tyre të përbashkët, poqese këtë e „mundësojnë” (në ligj thuhet „e kërkojnë”), ndryshimin e rrethanave,(rrethanat e ndryshuara).

Edhe në nenet 81 dhe 82 të kapitullit të IV të Ligjit për Familje, trajtohet e drejta Prindërore pas shkurorëzimit. Sipas nenit 81, gjykata do vendos për besimin e fëmijëve për përkujdesje dhe edukim edhe kur:

- 1) Bie aktgjykim, me të cilin konstatohet se martesë shuhet(nuk ekziston thuhet në ligj); dhe
- 2) Në konteste për konstatimin apo kundërshtimin e atësisë apo amësisë, poqese sjellja e vendimit, varësisht nga rrjedha e kontestit, si dhe nga rrethanat e rastit, është e mundshme dhe e nevojshme.

Kur sillet vendimi për besueshmëri të fëmijëve për kujdestari (përkujdesje) dhe edukim, gjykata, poqese ka nevojë, do të urdhërojë palën tek e cila janë fëmijët, në kohë të caktuar, t'ia dorëzojë fëmijët, prindit, gjegjësisht personit tjetër apo institucionit përkatës.

Kurse neni 82 parasheh që pas shkurorëzimit të martesës, në lidhje me realizimin e të drejtës prindërore dhe rregullimin e marrëdhënjeve personale dhe të kontakteve të drejtëpërdrejta të prindit me fëmijët tek i cili nuk janë fëmijët, Qendra për punë sociale, i ka po të njëjtat autorizime si në rastet kur prindët janë në martesë.²⁸

²⁷ Po aty, neni 80

²⁸ Ligji për familjen, neni 81,82

Sipas Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989 (OKB, 1989) , neni 9, paragrafi 3, përcakton: “Shtetet palë respektojnë të drejtën e fëmijës së ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit, që të mbajë rregullisht marrëdhënie vetjake dhe takime të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës” .²⁹

Në Ligjin për familje, nuk parashihet ndonjë rregull ligjore i cili në detaje dhe në mënyrë të sistemuar e rregullon çështjen e kontakteve midis fëmijës dhe prindit me të cilin nuk jeton fëmija pas shkurorëzimit. Vet fakti se vendimin për kontakte e merr Qendra për punë sociale, kjo shkakton probleme dhe konflikte të natyrave të shumta, gjë që negativisht ndikon tek fëmija dhe mund të mbaroj me ndryshime psiko-somatike dhe socio-psirike. Kjo paraqet një mangësi në legjislacionin familjar në RMV, pikërisht për faktin se prindi i cili fiton të drejtë e kujdesit, pengon zhvillimin e kontakteve me prindin tjetër me të cilin fëmija nuk jeton.

Si pjesë e reformave në legjislacionin familjar çështja e kontakteve duhet të rregullohet dhe të precizohet, me qëllim që mos të lejohet në bazë të veprimeve të ndryshme dhe vlerësimit të lirë, vendimin për kontaktet të fëmijës me prindin tjetër ta sjell Qendra për punë sociale. Zakonisht këtë vendim në shumë vende europiane e merr gjykata, pas marrjes së mendimit nga Qendra për punë sociale.

3.6. E drejta e përdorimit të banesës familjare

Fëmijët zakonisht jetojnë me prindërit e tyre biologjik. Megjithatë ka raste kur ata jetojnë vetëm me njërin prind, për arsye të ndryshme. Pavarësisht nga kjo prindërit kanë përgjegjësi dhe perkujdesje ndaj fëmijëve dhe gëzojnë një mori të drejtash dhe detyrash ndaj fëmijëve. Të drejtat dhe detyrat e prindërve ndaj fëmijëve numërohen: 1) vënia e emrit personal fëmijës, 2) - rruajtja dhe mirrëritja, 3) edukimi dhe arsimimi, 4) mbajtja (ushqimi), 5) përfaqësimi, 6) administrimi i pasurisë dhe 7) tjetërsimi dhe ngarkimi i pasurisë.³⁰

²⁹ Konventa Mbi të drejtat e fëmijës .UNICEF.org.

³⁰ Abdulla Aliu- Haxhi Gashi. E drejta familjare, fq.225

Obligim shumë i rëndësishëm i prindërve ndaj fëmijëve është përcaktimi i vendbanimit të tyre. Që nga lindja fëmija ka adresën e banimit në të cilën jeton bashkë me prindërit. “Banesa familjare” është e një rëndësie të madhe për familjen dhe për ruajtjen, përkujdesjen dhe zhvillimin e personalitetit të fëmijës. Në një numër të konsiderueshëm të rasteve, fëmijët e mitur jetojnë me prindërit e tyre, kjo është njëherit edhe një nga të drejtat themelore të fëmijëve të garantuar me Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Kur fëmija jeton me të dy prindërit, mundësitë për kënaqjen e nevojave të tij janë shumë më të mëdha sepse prindërit janë prezent gjithmonë për të ofruar kujdesin për jetën dhe shëndetin e fëmijës, ashtu që sigurohet një zhvillim psikosocial më stabil në personalitetin e fëmijës. Ligji për familje parashikon se fëmijët e mitur kanë të drejtë të jetojnë me prindërit e tyre (neni 47, paragrafi 1). Fëmijët e mitur mund të jetojnë të ndarë nga prindërit e tyre vetëm nëse kjo është në interes të drejtperdrejtë të fëmijëve.³¹ Kështu në rast të shkurorëzimit të prindërve, përcaktohet se si do të ndahet përdorimi i banesës familjare ndërmjet prindërve dhe si të sigurohet stabiliteti i fëmijëve. Megjithatë në të shumtën e rasteve, banesa familjare mbetet vendbanimi ku do të qëndroj fëmija, gjithnjë në interes maksimal të fëmijës, si e drejtë e pakontestueshme që fëmija të ketë vendbanim të qëndrueshëm dhe të sigurt. Qëndrimi i fëmijëve në banesën familjare mvaret nga marrëveshjet mes prindërve ose vendimeve gjyqësore. Ligji përcakton qartë dhe shprehimisht se duhet të dihet adresa e vendbanimit të fëmijës. Fëmijët duhet të jetojnë ekskluzivisht me njërin prind adresa e të cilit është vendbanimi i tyre i saktë dhe vetë dinamika dhe mënyra e takimit me prindin tjetër, si dhe ndarja e dhe organizimi i përmbushjes së detyrimeve të përditshme të prindërve ndaj fëmijëve, rregullohet me marrëveshje, ku në mënyre decide përcaktohet ndarja e detyrimeve. Përcaktimi i adresës së saktë të vendbanimit të fëmijëve është jashtëzakonisht i rëndësishëm për rritjen dhe zhvillimin psikologjik, sepse është jashtëzakonisht e rëndësishme që fëmijët të kenë sens dhe ta dinë se ku është shtëpia e tyre.

³¹ Emine Zendeli, Arta selmani-Bakiu, Dejan, Mickoviq, Angel Ristov .E drejta familjare, fq.222

3.7. Parimi i interesit më të lartë të fëmijës

Edhe pse nuk ka një definicion standard të “Interesit më të lartë të fëmijës”, termi përgjithësisht i referohet shqyrtimit që gjykata ndërmer kur vendos lidhur me llojet e shërbimit, veprimet dhe rregullat që do ti shërbejnë më mirë fëmijës për të përcaktuar: kush përshtatet më mirë për t’u kujdesur për fëmijën. Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një gjendje të shëndoshë fizike, mendore, morale, zhvillimin shpirtëror dhe shoqëror dhe të gëzojnë një jetë familjare dhe shoqërore të përshtatshme për fëmijë.

Në zbatimin e këtij parimi, duhet të merren parasysh:

1. Nevojat e fëmijës për zhvillim fizik dhe psikologjik, edukim dhe shëndet, siguri dhe qëndrueshmërinë, edukimin dhe përkatësinë në familje;
2. Pikëpamjet e fëmijës në varësi të moshës dhe pjekurisë së tij;
3. Jeta e fëmijës duke marrë parasysh situata të veçanta të abuzimit, neglizhencës, shfrytëzimit ose të tjera format të dhunës ndaj fëmijës dhe rreziku i mundshëm i shfaqjes së situatave të ngjashme në të ardhmen;
4. Aftësia e personave që kujdesen për fëmijën për t’iu përgjigjur nevojave të tij;
5. Vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave me të cilët kanë lidhje farefisnore, marrëdhëniet shoqërore dhe/ose shpirtërore.

Parimi i “interesit më të lartë” është bosht kryesor i Konventës për të Drejtat e Fëmijës , e cila në nenin 3 të saj parasheh që *“në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me “ fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.”*³² Kjo Konventë i jep fëmijës të drejtën që interesi i tij/saj më i lartë të vlerësohet dhe të merret si një konsideratë parësore në të gjitha veprimet apo vendimet që kanë të bëjnë me të, si në sferën publike ashtu edhe atë private. Parimi i interesit më të lartë të fëmijës duhet të udhëheqë të gjitha vendimet që ndërlidhen me fëmijët në kontakt me sistemin e drejtësisë. Këtij parimi, në shtetet anëtare të BE, i jipet rëndësi të veçantë.

³² Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) me vendime të ndryshme nga praktika gjyqësore i ka vënë konturat e përkufizimit të interesit më të lartë të fëmijës sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijës. Në çështjen Z dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, GJEDNJ i ka njohur “vendimet e vështira e të ndjeshme para së cilave mund të ndodhen shërbimet sociale dhe parimin e rëndësishëm kundërveprues të respektimit e ruajtjes së familjes.” Megjithatë, aty ku shërbimet sociale dështojnë që t'i mbrojnë fëmijët nga "neglizhenca e abuzimi serioz dhe afatgjatë” kemi të bëjmë me shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ). GJEDNJ konstaton se interesi më i lartë i fëmijës mund ta mbizotërojë atë të një prindi, varësisht nga natyra dhe serioziteti i tyre. Në veçanti, prindi nuk mund të marrë masa që do ta dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës. Për shembull, parandalimi i çrregullimit të “ekuilibrit emocional dhe psikologjik” të një fëmije mbizotëron ndaj interesit të prindit për ta parë fëmijën në rastet kur fëmija shpreh qartazi dëshirën për të mos e parë atë.³³

Në Ligjin për familje të RMV, parimi i interesit më të lartë të fëmijës nuk është paraparë si parim themelor. Ky parim është paraparë në Ligjin për delikuencën e të miturve dhe Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve. Ndonëse Maqedonia e Veriut i ka avancuar sado pak të drejtat e fëmijëve, parimi i interesit më të lartë të fëmijës duhet të inkorporohet në dispozitat themelore të Ligjit për familje dhe duhet të jetë fokusi kryesor, kur merret ndonjë vendim për fëmijën.

3.8. Konventa për të Drejtat e Fëmijës

Konventa për të Drejtat e Fëmijës e bën të detyrueshme mbrojtjen absolute të fëmijëve për të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Evropës, është ligji më universal për të drejtat e fëmijës dhe paraqet një nga dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare që rregullon një spektër të gjërë të të drejtave të fëmijës, duke e trajtuar fëmijën si një subjekt të veçantë, i cili ka të drejta të patjetërsueshme.

³³ CHILDREN FIRST: The Role of Centres for Social Work in Judicial Proceedings- OSCE.org

Konventa për të drejtat e fëmijëve, marrëveshja më e ratifikuar për të drejta të njeriut në botë, është instrument kryesor obligativ që i përfshin të drejtat, qytetare, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të fëmijëve. Republika e Maqedonisë së Veriut, si shtet trashëgimtar i ish-Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë, më 2 dhjetor 1993 e pranoi ratifikimin e kësaj konvente. Ja disa parime konform Konventës Evropiane mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijës: e drejta e fëmijës për jetë, mbijetesë dhe zhvillim, mosdiskriminimi dhe barazia e mundësive, interesi më i lartë i fëmijës, e drejta e pjesëmarrjes së fëmijëve (e drejta për tu dëgjuar).

Republika e Maqedonisë së Veriut i respekton dhe i siguron të drejtat që i përmban Konventa për të drejtat e fëmijës për çdo fëmijë nën jurisdiksionin e saj pa kurrfarë diskriminimi dhe pavarësisht racës, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, gjuhës, besimit, bindjes politike dhe ndonjë bindje tjetër, origjinës ose statusit tjetër të fëmijës ose të prindit ose kujdestarit të tij ligjor.³⁴ Në të gjitha aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me fëmijët, të rëndësishme primare janë interesat e fëmijës, pavarësisht asaj nëse ato i zbatojnë institucionet publike ose private për mbrojtje sociale, organet administrative ose organet ligjdhënëse. Fëmijës veçanërisht i jepet rasti të dëgjohet në të gjitha procedurat gjyqësore dhe administrative të cilat kanë të bëjnë me të, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes përfaqësuesit ose organit përkatës, në një mënyrë e cila është në pajtim me rregullat procedurale të ligjit nacional.

Procedurat para një autoriteti gjyqësor që ndikojnë tek fëmijët, janë procedurat për rastet familjare, në veçanti ato që përfshijnë ushtrimin e përgjegjësisë prindërore. Sipas Konventës, në procedurat që ndikojnë te një fëmijë, autoriteti gjyqësor vepron shpejt për të shmangur çdo vonesë të panevojshme dhe vihen në dispozicion procedura për të garantuar që vendimet e tij të zbatohen me shpejtësi. Në raste urgjente autoriteti gjyqësor, ka kompetencën për të marrë vendime, të cilat janë menjëherë të zbatueshme. Në Konventë, nuk anashkalohet edhe roli i prindërve në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesit më të lartë të fëmijës,

³⁴ Ministria e Punës dhe Politikës Sociale të RMV , Protokoll për bashkëpunim ndërsektorial se si të vepohet me fëmijët në rrugë , Shkup 2022

gjithnjë me angazhimin e mirëfilltë të institucioneve të shtetit.³⁵ Të gjitha shtetet anëtare, tek Kodet e tyre civile me të cilat rregullohen problemet e shkurorëzimeve dhe konform kësaj edhe raporti i të drejtave të fëmijëve dhe obligimet prindërore, pa përjashtim, duhet ti përmbahen parimeve të konventës Evropiane për të drejtat e fëmijëve.

4.PRINDËRIA E PËRBASHKËT – JOINT CUSTODY

4.1 Nocioni i përgjithshëm i prindërisë së përbashkët

Pas shkurorëzimit, si formë më sublimë për ta ruajtur kohezionin prindëror ndaj fëmijës, është arritja e marrëveshjes për prindëri të përbashkët. Ndryshe kjo, është si forma e re e prindërisë pas shkurorëzimit. Është e rëndësishme të theksohet se suksesi i marrëveshjeve të përbashkëta të kujdesit shpesh varet nga komunikimi efektiv, bashkëpunimi dhe fleksibiliteti midis prindërve.³⁶ Pra, prindëria e përbashkët është vazhdim i kujdesit të prindërve, (babait dhe nënës), ndaj fëmijës edhe pas shkurorëzimit. Ushtrimi i përbashkët i të drejtave prindërore është një formë e kujdesit që është karakteristikë për prindërit që jetojnë së bashku, (nëse janë formalisht dhe de facto të martuar, ose në një bashkësi të zakonshme). Pothuajse në të gjitha format, sipas ligjit modern, prindërit e martuar që jetojnë së bashku kujdesen bashkërisht rreth fëmijëve. Një ndryshim në formën e kujdestarisë mund të ndodhë për shkak të ndryshimit të gjendjes martesore, statusit pas shkurorëzimit të martesës ose në rast të përfundimit të jetesës së përbashkët, kur njëri nga prindërit mund të marrë përgjegjësinë e pavarur prindërore dhe të drejtat e obligimet që ndërlidhen me të. Kur bëhet fjalë për prindërit jashtëmartesor, zakonisht nëna si njeri nga prindët jashtëmartesor, kujdeset për fëmijën në mënyrë të pavarur, nëqoftëse nuk është krijuar bashkësia jashtëmartesore, dhe ata këtë e bëjnë së bashku, konform parimit të së drejtës prindërore ex lege.³⁷

³⁵ Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF)

³⁶ “ A guide to joint custody” -<https://www.noblesolicitors.co.uk/>

³⁷ Cvejić-Jančić, O. Zajedničko vršenje roditeljskog prava. Pravni život, str. 675-694

Prindëria e përbashkët (joint-custody), duhet të përfshihet si formë e re e ushtrimit të përbashkët të të drejtave prindërore pas shkurorëzimit dhe të inkorporohet në legjislacionet e të gjitha vendeve, duke marrë parasysh rritjen e numrit të shkurorëzimeve, e sidomos në vendet ku forma tradicionale e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore është ushtrimi i pavarur i të drejtave prindërore nga njëri prind. Maqedonia e Veriut po përdor ende këtë koncept shumë të vjetëruar të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore pas shkurorëzimit. Aktualisht në legjislacionin tonë familjar prindi me të cilin jeton fëmija ka të drejtën dhe obligimin të vendos për të gjitha çështjet lidhur me fëmijën, ndërsa prindi tjetër është i liruar nga kjo përgjegjësi.³⁸ Prindërit me kujdestari të përbashkët ndajnë përgjegjësinë dhe autoritetin ligjor për të marrë vendime të rëndësishme që ndikojnë tek fëmijët për çështje të tilla si edukimi, kujdesi mjekësor, praktika fetare dhe vendime të tjera thelbësore prindërore.³⁹

Ky koncept përpiqet të ndajë marrëdhëniet e prindërve nga marrëdhëniet ndërmjet partnerëve të martuar (jashtëmartesor), në atë mënyrë që, shikuar nga pikëpamja juridike, ti mbajë marrëdhëniet e njëjta ose të ngjashme të prindërve dhe fëmijëve edhe në rastet e ndryshimit të marrëdhënieve martesore, duke respektuar faktin se prindërimi nuk përfundon me shkurorëzim dhe se, si rregull, një fëmijë ka nevojë për të dy prindërit në zhvillimin e tij.

4.2. Veçoritë e prindërisë së përbashkët – Joint Custody

Meqë shkurorëzimi i martesës, për arsye të shumta e veçmas si pasojë e jetesës moderne, gjithnjë e më tepër shëndrohet në trend e veçmas në shoqëritë me zhvillim të shpejtë e të lartë industrial. Ndonëse një përqindje ende e vogël e këtyre shkurorëzimeve, përfundojnë me një marrëveshje bilaterale miqësore, ende është i lartë numri i shkurorëzimeve konfliktuoze. Në rastet e shkurorëzimeve me marrëveshje, prindëria e përbashkët nuk paraqet vështirësi dhe në këto raste fëmijët këtë ndarje të prindërve nuk e përjetojnë me trauma të larta dhe në njëfar

³⁸ Emine Zendeli, Arta selmani-Bakiu, Dejan, Mickoviq, Angel Ristov .E drejta familjare ,fq.246

³⁹ Scott. E. & Derdeyn. A. Rethinking joint custody.

mënyre janë edhe më tutje nën kujdesin optimal të prindërve, pra të nënës dhe babait, ndaj edhe aklimatizimi i tyre në rrethana dhe kushte të reja bëhet më i kapshëm për ta.⁴⁰ Për fat të keq, shkurorëzimi i martesës që përcillet me konflikt të lartë, madje dhe përmes mediacionit nuk arihet as edhe marrëveshje minimale që do t'ua mundësonte sadopak një prindëri të përbashkët që do ishte në favor të mirëqenies së fëmijëve.

Ky koncept është pranuar dhe legalizuar në shumë vende, veçanërisht në ato që, për shkak të rënies demografike gjithnjë e më të theksuar, po ndërmarrin hapa konkret për përmirësimin e natalitetit ose, si kombe, angazhohen për rritjen e numrit të anëtarëve të tyre. Një nga shembujt më të mirë të një politike të tillë demografike është Izraeli, ku sipas të dhënave statistikore, çdo vit lidhen më shumë marrëveshje për bashkëprindërimin sesa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Me qëllim të rritjes së natalitetit në vendet më të zhvilluara ekonomikisht, ku gjithnjë e më shumë po zvogëlohet – që është paradoks, por edhe fakt – po promovohet në mënyrë gjithëpërfshirëse koncepti i prindërimit të përbashkët.

Që ky koncept të jetësohet dhe të funksionoj në mënyrën më të mirë për fëmijën, është e nevojshme, që prindërit të kenë një marrëdhënie të mirë reciproke dhe që funksionimi i tyre të jetë i koordinuar në mënyrë që ata të bien dakord për ndërmarrjen e aktiviteteve dhe respektimin e njëri-tjetrit. Shumica e prindërve theksuan se ky koncept i kujdestarisë, pra ushtrimi i përbashkët i të drejtave prindërore, është mjaft kërkues për ta, por pas shkurorëzimit ky koncept është më pak stresues për fëmijët, sepse ata janë të privuar nga ndjenja e humbjes së njërit prej prindërve. Që të realizohet ushtrimi i përbashkët i të drejtave prindërore, prindërit duhet të arrijnë një marrëveshje. Me marrëveshjen për ushtrimin e përbashkët të së drejtës prindërore, prindërit e fëmijës bien dakord me shkrim që të drejtat dhe detyrat prindërore t'i ushtrojnë bashkërisht, me marrëveshje të ndërsjellë, e cila duhet të jetë në interesin më të lartë të fëmijës. Koncepti i kujdesit të përbashkët përfshin dy komponentë të këtij termi: *kujdestaria e përbashkët ligjore dhe ajo fizike*, kujdesi i përbashkët faktik apo rezidencial.

⁴⁰ Opie, Anne. Ideologies of Joint Custody. *Family Court Review* 31

Kujdestaria e përbashkët ligjore përfshin vendosjen për çështje thelbësore; çështjet që lidhen me fëmijën, dhe kur bëhet fjalë për marrëdhëniet personale, autorët kryesisht me çështje të rëndësishme nënkuptojnë para së gjithash arsimin, shëndeti i fëmijës, udhëtimet jashtë vendit, çështjet fetare, etj. Në kujdesin e përbashkët përfshihen edhe të drejtat dhe detyrimet në lidhje me marrëdhëniet pasurore. Kujdesi fizik i përbashkët do të thotë që të dy prindërit në fakt kujdesen për fëmijën, në mënyrë që fëmija të ketë në dispozicion dy shtëpi. Teorikisht, në rastet tilla flitet për një formë të re të familjes të ashtuquajturat bi-bërthamore.⁴¹ Që të ekzistojë kujdesi i përbashkët është i mjaftueshëm, sipas mendimit të shumicës së autorëve, kujdestaria ligjore e përbashkët, ndërsa kujdesi fizik i përbashkët nuk është kusht i domosdoshëm i ekzistencës së tij, edhe pse gjykatat mund të përcaktohen për të dyjat.

4.3. Rëndësia universale e përfshirjes të prindërisë së përbashkët në kodin Civil të ri të RMV

Meqë ekzistojnë dilema rreth asaj a thua E drejta Familjare duhet të jetë pjesë e Kodit Civil, apo çështjet juridike që i takojnë kompleksitetit Familje, duhen rregulluar me ligj të veçantë, mendoj se kjo e drejtë duhet të përfshihet në Kodin civil të ri por me plotësimin e të gjitha zbrazëtirave juridike që përmban Ligji për familjen.

Pra, me zhvillimin historik të civilizimeve në përgjithësi dhe të shoqërisë në veçanti, ku hyn edhe zhvillimi historik i Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV), edhe Ligji për të drejtën familjare është kodifikuar. Kuptohet, në rrugëtimin e RMV drejt Bashkimit Evropian, konform direktivave të legjislacionit evropian, duhen rregulluar edhe legjislacionet përkatëse të RMV. Pas pavarimit të Maqedonisë nga Federata Jugoslave, pothuajse të gjitha ligjet, përfshi edhe ata që kanë të bëjnë me Kodin Civil, u trashëguan nga legjislacioni jugosllav. Deri në vitin 2010, kur u bë përpjekje për reformimin pozitiv të Kodit Civil, vlenin ligjet e ish federates. Meqë bëhet fjalë për një lëmi juridike tejet komplekse, kuptohet se njësitë përbërëse të lëmisë kanë paqartësi dhe kontradikta që dalin nga konceptet ideore dhe politike të socrealizmit.

⁴¹ Ahrons, C.R. The binuclear family; Parenting roles and relationships, parent-child relationship post divorce pg.54-79

Duke marrë parasysh kompleksitetin e materjes të së drejtës familjare e në veçanti ku shtjellohet shkurorëzimi i martesës, pastaj edhe ushtrimi i të drejtave prindërore pas shkurorëzimit, materje kjo që aktualisht, nga këndvështrimi juridik, në RMV, trajtohet përmes Ligjit për Familje me shumë mangësi, mendoj se duhen bërë përpjekje që kjo problematikë, të trajtohet me përfshirjen të gjitha të drejtave prindërore, ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, prindërinë e përbashkët pas shkurorëzimit, gjithmonë duke pasur prioritet mirëqenien e fëmijës, duke respektuar dhe përfshirë parimin e interesit më të lartë të fëmijës.

Përfshirja e së drejtës familjare në Kodin Civil do ta afrojë RMV drejt standardeve juridike që janë prezente në shumicën e vendeve evropiane, të cilat kanë kodifikime civile dhe do të kontribuojë për siguri më të madhe juridike dhe realizim më të lehtë të të drejtave dhe interesave të qytetarëve në marrëdhëniet juridiko-familjare.⁴² Në legjislacionin evropian e drejta prindërore shihet gjithnjë e më pak si pushtet por si detyrë e prindërve në dobi të fëmijëve. Kuptimi, shtrirja dhe kufijtë e të drejtave prindërore përcaktohen nga interesi më i lartë i fëmijës dhe nevoja për të mundur realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tij. Prandaj, përmbajtja e të drejtave prindërore në RMV duhet të ndryshohet dhe përshtatet me të drejtat dhe interesat e fëmijës si subjekt qendror i marrëdhëniet juridike në familje.

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës e bën të detyrueshme mbrojtjen absolute të fëmijëve për të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Evropës dhe vendeve të botës.

Nga ajo që u cek më lartë, që ka të bëjë me prindërinë e përbashkët pas shkurorëzimit, përshkak të mungesës së determinimit të zgjeruar të nevojës dhe rolit të prindërisë së përbashkët, veçmas pas shkurorëzimit të martesës, kjo materje sublimë e “Ligjit për familje”, ka nevojë të përpunohet dhe të plotësohet me amendamente duke trajtuar në mënyrë më sistematike raportet mbrenda në familje, sidomos rastet pas shkurorëzimit të martesës dhe prindërinë. Mbrenda këtyre raporteve, ka shumë gjëra që si në aspektin deontologjik poashtu edhe në aspektin juridik, në ligjin aktual për familjen nuk janë sistematizuar e aq më tepër nuk

⁴² Emine Zendeli, Arta selmani-Bakiu, Dejan, Micković, Angel Ristov. E drejta familjare ,fq.25

janë qartësuar, në veçanti, kur bëhet fjalë për interesin optimal të fëmijëve. Ligji në fuqi për familjen i RMV, ndonëse në mënyrë taksative i cek parimet e shkurorëzimit dhe mundësitë e prindërisë pas shkurorëzimit, mendoj se nuk janë precizuar rrethanat dhe kushtet të cilat e mbrojnë fëmijën nga padrejtësitë me të cilat mund të ballafaqohet ai, duke marrë parasysh interesin më të lartë të tij. Legjislacioni i shteteve të Bashkimit Evropian, për çdo mirëqenie të fëmijës, qofshin ato fizike, psikike, ekonomike, sociale e shëndetsore, këto të drejta i trajton në mënyrë të veçantë.(shih kapitullin Aspektet krahasimore të kësaj materje juridike me disa shtete europjane: Francë, Austri, Gjermani, Suedi). Përsosmëria e ligjeve dhe kodeve civile është nevojë e çdo shoqërie moderne që udhëhiqet nga parimet e demokracisë funksionale.

4.4. Impakti i prindërisë së përbashkët pas shkurorëzimit të martesës në mirëqenien e fëmijëve

Statusi juridik i fëmijës ndryshoi nën ndikimin e të drejtave themelore, në veçanti, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve e vitit 1989, zbatimi dhe efektiviteti i së cilës në Evropë është inkurajuar dhe promovuar nga ndikimi në rritje i ligjeve evropiane ndaj atyre ndërkombëtare. Kjo çon në vendosjen e një ekuilibri ligjor midis fëmijës dhe prindërve të tij, deri në zhdukjen e një koncepti autoritar të të drejtave prindërore, i cili tashmë është prezent nëpërmjet shprehjeve juridike e gjuhësore. Në Francë dhe Belgjikë, termi ligjor „autoriteti prindëror” është zëvendësuar me “pushtetin prindëror”, në Angli “pushteti prindëror zëvendësohet me termin “autoritetin prindëror” dhe më pas me “përgjegjësinë prindërore”. Në Gjermani “autoriteti i babait”u zëvendësua me “kujdes prindëror”. Këto ndryshime të legjislacionit evropian konfirmojnë se e drejta prindërore shihet gjithnjë e më pak si pushtet por si detyrë e prindërve në dobi të fëmijëve.⁴³ Prandaj, përmbajtja e të drejtave prindërore ndryshon dhe përshtatet me të drejtat dhe interesat e fëmijës si subjekt qendror i marrëdhënieve juridike në familje dhe prindëria e përbashkët pas shkurorëzimit inkorporohet si formë përkujdesjeje në situatat në të cilat forma

⁴³ Ковачек Станић. Гордана, Аутономија VERSUS материјална истина у компаративном праву о породичном статусу детета, стр. 195–222

tradicionale e kujdesit ishte ushtrimi i të drejtave prindërore nga njëri prind. Duke u nisur nga kjo, mund të konstatohet se të drejtat prindërore mund të ushtrohen bashkërisht, pavarësisht nëse prindërit e fëmijës ose fëmijët jetojnë së bashku apo bashkësia e jetës në familje ka përfunduar.

Familjet moderne, të udhëhequra nga prindërimi i përbashkët, sjellin kompleksitet më të madh në marrëdhëniet ndërpersonale për shkak të kombinimit të prejardhjeve të ndryshme familjare dhe në këtë mënyrë inkurajojnë tolerancën dhe përshtatshmërinë tek anëtarët e tyre. Në aspektin sociologjik, ato sfidojnë normat tradicionale dhe promovojnë diversitetin dhe pajtueshmërinë, gjë që kontribuon në dinamikën e përgjithshme të shoqërisë dhe krijon dhe reflekton një mjedis më të hapur dhe gjithëpërfshirës për të gjithë anëtarët e saj.

Një prindëri e përbashkët mvaret kryesisht nga mënyra se si kanë jetuar partnerët në fazën e mëparshme të jetës, që është faza para konceptimit të një fëmije. Idetë për mënyrën sesi prindërit do të sillen shpesh bazohen në fëmijërinë e tyre dhe kaliten nga përvoja jetësore personale ose nga mjedisi. Meqenëse dy njerëz nuk rriten saktësisht në të njëjtën mënyrë, sigurisht që do të ketë ndryshime në mënyrën se si prindërit mendojnë se një fëmijë duhet të rritet. Dhe ndikimi nuk është vetëm i tyre, por ka rëndësi edhe përvoja e tyre martesore. Të vendosësh të jesh prind me probleme të pazgjidhura nga faza e mëparshme e marrëdhënies së partnerit, mbart rrezikun e thellimit të krizës në marrëdhënien e partnerit dhe rrezikun e ndikimit të problemeve të pazgjidhura të partnerit në prindëri. Nëse marrëdhënia martesore do të jetë më e mirë apo jo, pas lindjes së një fëmije, varet nga mënyra se si partnerët i zgjidhin detyrat me të cilat përballen pas formimit të martesës: vendosja e kufijve midis marrëdhënies së partneritetit dhe mjedisit, d.m.th. marrëdhëniet me familjet kryesore të origjinës, miqtë, individët e tjerë, gatishmëria e partnerëve për të punuar për ruajtjen dhe kohëzgjatjen e marrëdhënieve, kujdesi, vëmendja, shkëmbimi emocional, vendosja e modeleve të komunikimit, aftësia për të njohur dhe punuar mbi mosmarrëveshjet që janë të pashmangshme, intimiteti, ekuilibri i fuqisë, si dhe detyrat tjera specifike.

Një koalicion i mirë dhe i suksesshëm bashkëshortor-prindëror është një faktor i madh mbrojtës për fëmijën dhe një nga pikat e forta të familjes. Një marrëdhënie e suksesshme martesore është një cilësi thelbësore për prindërimin dhe funksionimin funksional të familjes. Është e rëndësishme të ceket se nëse prindët e fëmijës janë në martesë apo në raste jashtë martesore janë në lidhje, apo aktualisht të ndarë ose të divorcuar, fëmija duhet t'i shohë prindërit e tyre në një këndvështrim pozitiv. Prindërit duhet tu japin fëmijëve të tyre modelin e parë se çfarë është një marrëdhënie dhe si duket ajo. Kjo është arsyeja pse është kaq e rëndësishme t'i tregohet fëmijës një marrëdhënie pozitive, produktive dhe respektuese. Marrëdhënia duhet të jetë e një cilësie të lartë pavarësisht shkurorëzimit, gjithmonë duke menduar dhe vepruar për mirëqenien e fëmijëve.

Prindëria e përbashkët pas shkurorëzimit duhet të jetë një partneritet që ndërton dhe përfaqëson një themel të fortë për fëmijën, duke përfshirë të dy prindërit. Prindërit duhet të mbështesin vendimet e njëri-tjetrit dhe të punojnë si njësi për të rritur fëmijën e tyre. Një lidhje e fortë me prindërit redukton stresin e fëmijës dhe ofron siguri. Bashkëprindërimi harmonik gjithashtu ndihmon çdo prind të balancojë përgjegjësitë e prindërimit duke pasur një person tjetër ku të mbështetet dhe të marrë vendime.⁴⁴ Në këtë mënyrë reduktohet stresi. Gjithnjë duhet respektohen gjërat që krijojnë marrëdhënie pozitive gjatë prindërimit të përbashkët, siç janë: shmangja nga bisedat që ndikojnë negativisht për prindin tjetër para fëmijës. Të shmangen debatet konfliktuale dhe të praktikohen biseda të qeta dhe produktive para fëmijës. Duhet bërë rutinë që prindët mes veti të flasin qetësisht dhe në mënyrë afirmative para fëmijës, duke përfshirë çdo vendim që duhet diskutuar dhe marrë së bashku. Të diskutohet dhe të krijohet strategji e përbashkët prindërore (disiplina, koha e gjumit, pritshmëritë, etj.). Ajo që është më me rëndësi ndërlidhet me qëndrimin besnik dhe me ballafaqim e sfidave gjatë prindërimit.

⁴⁴ Leslie J. Harris, Lee E. Teitelbaum. Children, Parents, and the Law: Public and Private Authority in the Home, Schools, and Juvenile Courts-, pg.356

Gjatë procedurave juridike të shkurorëzimit të martesës, është e rëndësishme që të vehet në qendër impakti i prindërisë së përbashkët dhe përqëndrimi i prindërve dhe i gjyqeve të jetë në funksion të ruajtjes së drejtave të fëmijëve dhe mirëqenies së tyre. Pra, fëmijët varen nga të rriturit, prandaj kanë nevojë për mbrojtje dhe ndihmë të veçantë. Të drejtat e fëmijëve janë të drejta të veçanta të njeriut për personat nën 18 vjeç. Ato bazohen në të drejtat e garantuara me akte ndërkombëtare dhe me fondacionet e brendshme. Qëllimi i të drejtave të fëmijëve është t'i orientojë fëmijët drejt mirëqenies së tyre të përgjithshme. Kujdesi për fëmijët përfshin angazhimin e veçantë të prindërve për mirëqenien fizike dhe shëndetin, si dhe mbikëqyrjen e tyre. Interesimi dhe zbatimi i lartë i këtij koncepti nga shtetet evropiane, kanë sjellë vlerësime pozitive. Është e rëndësishme të përmendet se kujdesi i përbashkët nuk është e domosdoshme të jetë një ndarje 50/50 të kohës me secilin prind, ndarja e kohës mund të ndryshojë në varësi të rrethanave dhe në bazë të asaj se cka është përcaktuar si më e mira për fëmijën. Marrëveshjet e kujdesit të përbashkët synojnë të vendosin bashkëpunimin dhe komunikimin mes prindërve për mirëqenien e fëmijës dhe për të siguruar që të dy prindërit të jenë të përfshirë në rritjen e tyre.

4.5. Avantazhet dhe disavantazhet e prindërisë së përbashkët pas shkurorëzimit

Prindëria e përbashkët mund të jetë një model i suksesshëm për disa familje, ndërsa për të tjera, mund të paraqesë sfida të vërteta dhe këto mund të ndikojnë në mënyrë të ndryshme në fëmijë dhe prindër. Këtu janë disa nga avantazhet dhe disavantazhet e prindërisë së përbashkët:

Avantazhet e prindërisë së përbashkët: prindëria e përbashkët u mundëson prindërve për të ndarë kënaqësinë dhe përgjegjësinë e rritjes së fëmijëve, dhe i jep fëmijës besimin se është ende i dashur nga të dy prindërit. Mbajtja e kontaktit me të dy prindërit shmang ndjenjën traumatike të humbjes që përjetojnë fëmijët të cilat i janë besuar njërit prind. Përveç kësaj,

lidhjet psikologjike mes prindërve dhe fëmijës mbeten një realitet dhe burim i emocioneve duke siguruar stabilitet për të gjithë ata.

Gjithashtu, kujdestaria e përbashkët mund të zvogëlojë armiqësinë që shpërthen mes prindërve sepse fëmija i është besuar njërit prej tyre. Prindërit mund të ndajnë përgjegjësitë dhe detyrat mes tyre, duke ndihmuar në ndarjen e barrës së punës dhe kujdesit për fëmijët. Fëmijët që shohin prindër të bashkuar dhe të angazhuar kanë mundësi të mësojnë nga shembulli pozitiv dhe të ndërtojnë marrëdhënie të shëndetshme kur rriten. Duke ndarë përgjegjësitë financiare, prindërit e përbashkët mund të menaxhojnë më mirë buxhetin, të ofrojnë mjedis financiar më të stabilizuar për fëmijët dhe të sigurohet një bazë financiare më e fortë, pasi të dy prindërit mund të kontribuojnë në mënyrë të barabartë në kujdesin dhe shpenzimet për fëmijën.

Disavantazhet e prindërisë së përbashkët: ana negative e kujdestarisë së përbashkët është konfuzioni që mund të shkaktohet për fëmijët. Fëmijët mund të ndihen konfuz kur prindërit jetojnë të ndarë dhe kanë rregulla të ndryshme në dy ambiente të ndara. Prindëria e përbashkët mund të sjellë tensione dhe mosmarrëveshje midis prindërve, veçanërisht në lidhje me çështje të përditshme të kujdesit për fëmijën ose çështje financiare.

Për të funksionuar me sukses prindëria e përbashkët kërkon një komunikim të mirë ndërmjet prindërve. Në raste të komunikimit të dobët, kjo mund të shkaktojë vështirësi në koordinim të përgjegjësive dhe kujdesit për fëmijën.

Si disavantazh i prindërisë së përbashkët është edhe rreziku i ndarjes së prindërve. Prindëria e përbashkët mund të rritë rrezikun e ndarjes përfundimtare të prindërve, duke e lënë fëmijën në një situatë emocionale të vështirë.

Autori Homer Clark (Homer Clark), duke iu referuar autorëve të ndryshëm, veçon disavantazhet e kujdesit të përbashkët, duke theksuar se ato kanë më shumë gjasa të rezultojnë nga kujdestaria e përbashkët fizike e jo nga kujdestaria e përbashkët ligjore. Kritikët e kujdesit të përbashkët theksojnë nevojën e fëmijës për stabilitet dhe të konkludohet se kujdestaria e përbashkët shpeshëherë e bën të pamundur stabilitetin. Duhet theksuar vështirësitë praktike

në zbatimin e kujdesit të përbashkët kur prindërit jetojnë larg njëri-tjetrit. Ata gjithashtu paraqesin disavantazhe të cilat ekzistojnë në rastet kur nëna ka pasur kujdestarinë gjatë rritjes së fëmijës, kurse babai bën kërkesë për kujdestari të përbashkët (të cilat inkurajohen nga dispozitat ligjore të shumicës së vendeve). Pastaj ajo kërkesë mund të përdoret si një formë shantazhi kryesisht në lidhje me nënën. Shqetësuese është zvogëlimi i kërkesës për mbajtje, e cila është pasojë e frikës së nënës se pjesërisht do ta humbas fëmijën nëse i jepet kujdestaria e përbashkët.⁴⁵

Përveç kësaj, në rast se prindërit nuk kanë një angazhim të fortë për të arritur kujdestarinë e përbashkët, mund të vazhdojnë konfliktet që e shkaktojnë shkurorëzimin dhe që bëjnë që fëmija të ndjejë ankth dhe fëmijët mund të marrin një shembull të gabuar për marrëdhëniet e tyre të ardhshme.

4.6. Aspektet krahasimore të kësaj materje juridike me disa shtete evropiane si Francë, Austri, Suedi, Gjermani

Sa për krahasim do veçoj disa shtete, ku do trajtohet harmonizimi i disa të drejtave dhe detyrimeve të prindërve ndaj fëmijëve.

FRANCA

Përgjegjësia prindërore në Francë përkufizohet si një grup i të drejtave dhe detyrimeve që mbrojnë interesat e fëmijës. Ajo u përket prindërve derisa fëmija të bëhet i rritur ose të fillojë të kujdeset për veten. Prindërit janë të detyruar të mbrojnë sigurinë, shëndetin dhe vlerat morale të fëmijës, ta rrisin fëmijën dhe të lehtësojnë zhvillimin e tij, duke respektuar individualitetin e tij. Duke qenë se ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, nënat dhe baballarët janë edhe përfaqësues ligjorë të fëmijës dhe në këtë cilësi përfaqësojnë fëmijën në të gjitha

⁴⁵ "Victoria Mather, Evolution and Revolution in Family Law,25

çështjet civile dhe menaxhojnë pasurinë e tij. Të dy prindërit kanë përgjegjësi të barabartë prindërore. Koncepti i autoritetit atëror (puissance paternelle) u shfuqizua në Francë në vitin 1970. Baballarët dhe nënat që së bashku ushtrojnë përgjegjësinë prindërore ndaj fëmijës duhet të marrin vendime bashkërisht për të gjitha çështjet e rëndësishme që prekin fëmijën (zhvendosje, transferim në një shkollë tjetër, procedura kirurgjikale etj.).

Nëse prindërit shkurorëzohen ose i japin fund marrëdhënies, si zgjidhet çështja e përgjegjësisë prindërore në të ardhmen?

Ndërprerja e marrëdhënieve mes prindërve nuk i cënon rregullat për kalimin e së drejtës për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore. Të dy prindërit duhet të vazhdojnë të kujdesen për fëmijën dhe të marrin vendime të përbashkëta në interes të fëmijës. Nëse prindërit nuk arrijnë një marrëveshje, gjyqtari i gjykatës së familjes do të vendosë për rregullimin e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore në një procedurë shkurorëzimi ose një procedim që lidhet me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, duke pasur parasysh sa vijon:

1. mënyra se si zakonisht janë sjellë prindërit dhe marrëveshjet e tjera të mundshme që kanë arritur më parë
2. mendimet e një fëmije të mitur të paraqitura në gjykatë
3. aftësinë e secilit prind për të kryer detyrat e tij dhe për të respektuar të drejtat e prindit tjetër
4. rezultati i ekspertimit, veçanërisht duke marrë parasysh moshën e fëmijës
5. informacionet e marra si pjesë e hetimeve apo kundërhetimeve të kryera nga shërbimet sociale
6. presioni ose dhuna fizike ose psikologjike e njërit prind ndaj tjetrit.

Prindërit mund të arrijnë një marrëveshje për të gjitha masat që zbatohen në përputhje me interesat e fëmijës dhe të hartojnë një marrëveshje prindërore në mënyrë të pavarur ose me ndihmën e një ndërmjetësi ose avokatëve të tyre.⁴⁶

Termi “kujdestaria e fëmijës” (garde de l’enfant) u hoq në ligjin francez të familjes në 1987. Koncepti kujdestarisë së përbashkët (garde conjointe) në të drejtën franceze mund të interpretohet në një kuptim më të gjerë, si ushtrim i përbashkët i përgjegjësisë prindërore, ose në një kuptim më të ngushtë, si përcaktimi i vendbanimit të fëmijës që alternohet midis adresave të banimit të çdo prind (kjo nganjëherë quhet kujdestari alternative, megjithëse një term i tillë konsiderohet ligjërisht i pasaktë - termi që duhet të përdoret është “vendbanim alternativ”. Prindërit në parim e ushtrojnë përgjegjësinë prindërore bashkërisht pa pasur nevojë për vendime gjyqësore. Në të drejtën franceze vendoset parimi i prindërimit të përbashkët. Kjo do të thotë se secili prej prindërve merr pjesë në jetën e fëmijës në masë të barabartë dhe siguron kujdesin e nevojshëm ditor. Ushtrimi i përbashkët i përgjegjësisë prindërore nënkupton që prindërit marrin së bashku të gjitha vendimet e rëndësishme që prekin fëmijën. Fëmija mund të qëndrojë me prindërit dhe në mënyrë alternative, nga një javë me secilin prind.

Në Francë, autoriteti prindëror ushtrohet bashkërisht pas shkurorëzimit të martesës, prezantuar si parim në vitin 1993 dhe e rregulluar nga neni 387 i Kodit civil . Është e nevojshme të përcaktohet vendbanimi i rregullt i fëmijës dhe në rastin kur prindërit nuk janë në gjendje të bien dakord për këtë, ose nëse rezulton se marrëveshja e tyre nuk është në interesin më të mirë të fëmijës, ndërhyjnë gjykatat. Vendimi i ligjit të vitit 1993 është vërtetim i praktikës gjyqësore sipas të cilit gjyqtarët caktonin autoritetin prindëror ndaj njëres palë vetëm në raste të kufizuara. Ushtrimi i përbashkët i autoritetit prindëror definohet si rregulli me Ligjin për autoritetin prindëror nga viti 2002. Ky rregull lihet mënjanë kur nuk është vërtetuar prejardhja e fëmijës brenda 1 vit nga lindja ose nëse përcaktohet në një proces gjyqësor. I njëjti rregull zbatohet për ushtrimin e përbashkët të autoritetit prindëror, pavarësisht nëse janë prindërit e

⁴⁶ Parental responsibility-child custody and contact rights in France;

fëmijës së lindur, të martuar ose jo, pavarësisht nëse jetojnë së bashku apo jo. Përveç kësaj, gjyqtari ka mundësinë të përcaktojë, edhe nëse prindërit nuk kanë arritur një marrëveshje, për faktin se vendbanimi i fëmijës do të jetë në mënyrë alternative në shtëpitë e njërit, apo një prind tjetër. Për shkak të kësaj, ekziston një detyrim i prindit që largohet nga shtëpia për të informuar prindin tjetër për këtë, në mënyrë që prindi të mund të gjurmojë mundësi të përshtatshme. Gjyqtarët për çështje familjare i ndryshojnë mënyrat e ushtrimit të autoritetit prindëror (Kodi civil, neni 373-2-9). Rregulli i përgjithshëm për ushtrimin e përbashkët të autoritetit prindëror zbatohet në të njëjtën mënyrë dhe ajo vlen edhe për familjen me adoptim, duke qenë se tani e tutje, kur një bashkëshort adopton fëmijën e tjetrit, prindi biologjik dhe prindi adoptues mund të krijojnë ushtrim të përbashkët të autoritetit prindëror me deklaratë të përbashkët, ndërsa më parë, prindi biologjik ushtronte autoritetin prindëror. Në rastet e ndarjes, gjyqtari ende mund të konstatojë se është i pavarur ushtrimi i autoritetit prindëror nga njëri prind si zgjidhje më e mirë, nëse është në interes të fëmijës, por, sipas mendimeve të shprehura në teori, vendimet e gjykatës sugjerojnë se kjo mundësi do të përdoret vetëm në rrethanat më ekstreme, kur ushtrimi i përbashkët i autoritetit prindëror mund të rrezikojë mirëqenien e fëmijës.⁴⁷ Heqja e autoritetit prindëror është bërë e jashtëzakonshme, në bazë të nen. 373 Kodi civil. Ligji i 4 marsit 2002 i mundëson prindit të ndajë kujdesin prindëror me një të tretë i cili, sipas mendimit të shprehur në teori, mund të jetë njerë apo njerë, plotësisht ose pjesërisht, nëse e kërkon arsimimi i një fëmije. Kur të dy prindërit ndajnë autoritetin prindëror, është e nevojshme që të dy të bien dakord të ndajnë pushtetin me një palë të tretë.

AUSTRIA

Sipas Kodit Civil Austriak, përgjegjësia prindërore është detyrë dhe e drejtë e prindërve. Ndër të tjera, këtu përfshihet kujdesi ndaj fëmijës dhe edukimi i tij, administrimi i pasurisë së fëmijës dhe përfaqësimi i fëmijës (neni 158 i Kodit Civil Austriak – Allgemeines Bürgerliches

⁴⁷ Country reports for France - <https://ceflonline.net/>

Gesetzbuch). Në përputhje me nenin 160 të Kodit Civil austriak, kujdesi për fëmijët nënkupton kryesisht kujdesin për mirëqenien fizike dhe shëndetin e fëmijës dhe mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të fëmijës, ndërsa rritja e një fëmije përfshin në mënyrë specifike sigurimin e zhvillimit fizik, mendor, emocional dhe moral të fëmijës dhe promovimi i talenteve, aftësive, prirjeve dhe potencialit zhvillimor të fëmijës dhe edukimit, gjegjësisht aftësimit të tij profesional. Kujdesi përfshin trajtimin e një fëmije kurse rritja e një fëmije nënkupton gjithashtu, marrjen e një vendimi për vendbanimin e fëmijës (neni 162 i Kodit Civil austriak), ku rregullohet marrja e vendimeve për udhëtimin në një vend të huaj, zgjedhjen e shkollave, dhe zgjedhjen ose ndryshimin e fesë së fëmijës. E drejta e prindërve për të rritur një fëmijë përfshin gjithashtu të drejtën për të emëruar fëmijën.

Neni 164 i Kodit Civil austriak thotë se prindërit janë të detyruar të menaxhojnë pasurinë e fëmijës “me një kujdes të veçantë të tyre”. “Përfaqësimi ligjor” i fëmijës përkufizohet si e drejtë dhe detyrim për të kryer veprime juridike në emër të fëmijës. Kjo përfshin përfaqësimin e fëmijës në rastet kur të drejtat ose detyrimet i caktohen drejtpërdrejt fëmijës ose dhënien e pëlqimit në emër të fëmijës. Me ligj rregullohen edhe shumë të drejta personale të fëmijëve, të cilat në këtë punim nuk do të përmendim.

Si rregull, nëse fëmija ka lindur në martesë ose nëse prindërit janë martuar pas lindjes së fëmijës, të dy prindërit do të kenë kujdestarinë e fëmijës (neni 177 paragrafi 1 i Kodit Civil austriak). Nëse fëmija lind jashtë martese, me ligj kujdestarinë e fëmijës e ka vetëm nëna (neni 177, paragrafi 2, fjalia e parë e Kodit Civil Austriak). Nëse kujdestaria i jepet vetëm njërit prind, tjetri do të ketë të drejtën e kontaktit personal me fëmijën dhe të drejtën për informacion, shprehje dhe përfaqësim, siç përcaktohet në nenin 189 të Kodit Civil Austriak. Nëse asnjëri prej prindërve nuk mund të ushtrojë kujdestarinë, gjykata duhet të vendosë se cilit gjysh (ose njërit prej tyre) ose cilit prind kujdestar duhet t’i jepet kujdestaria e fëmijës. Nëse kujdestaria do t’u jepet gjyshërve ose prindërve kujdestarë, çifti në përgjithësi do të ketë përparësi ndaj gjyshit ose njërit prind kujdestar, përveç rasteve kur kjo është në interesin më të mirë të fëmijës. Nëse

asnjëri prind nuk është në gjendje të ofrojë një aspekt të veçantë të kujdesit, kjo do të zbatohet në përputhje me rrethanat. Mirëqenia e fëmijës është gjithmonë kriteri kryesor për dhënien e kujdestarisë.

Kujdestaria e përbashkët zbatohet edhe pas shkurorëzimit ose anulimit të martesës. Megjithatë, nëse prindërit dëshirojnë të mbajnë kujdestarinë e përbashkët si më parë, ata duhet t'i paraqesin gjykatës një marrëveshje brenda një kohe të arsyeshme që tregon se me cilin prind do të banojë kryesisht fëmija. Gjykata duhet të miratojë marrëveshjen nëse është në interesin më të mirë të fëmijës. Prindërit mund të mos ndajnë kujdestarinë në mënyrë që, për shembull, njëri prind të jetë i vetmi përgjegjës për kujdesin dhe edukimin e fëmijës, ndërsa tjetri të menaxhojë vetëm pasuritë e fëmijës dhe të përfaqësojë fëmijën; prindi me të cilin fëmija banon kryesisht duhet të ketë gjithmonë kujdestarinë e plotë. Nëse kjo marrëveshje nuk dorëzohet brenda një kohe të arsyeshme pas përfundimit të martesës, ose nëse nuk është në interesin më të mirë të fëmijës, nëse pëlqimi nuk mund të arrihet me marrëveshje dhe nëse kjo është e nevojshme pas pajtimit, merret një vendim se cili prind do të ketë kujdestarinë e vetme mbi fëmijën në të ardhmen.

Prindërit gjithashtu mund të vendosin që pas përfundimit të martesës, kujdestarinë e fëmijës ta mbajë vetëm njëri prind.

Nëse prindërit nuk arrijnë marrëveshje optimale, ata mund të kontaktojnë shërbimet e mirëqenies së fëmijëve ose të rinjve (këshillimi familjar) ose organizata private për këshilla. Vetëm gjyqtari i gjykatës së kujdestarisë (Pflegschaftsgericht) mund të nisë zyrtarisht dhe të marrë në konsideratë procedurat lidhur me kujdestarinë dhe të drejtat e kontaktit. Nëse ekziston një rrezik i konsiderueshëm për mirëqenien e fëmijës, duhet të njoftohen shërbimet e mirëqenies së fëmijëve dhe të rinjve. Nëse fëmija është në rrezik, ata mund të marrin masat e duhura, duke përfshirë heqjen e kujdestarisë në rastet më të rënda.

Të gjithë personat që kanë kujdestarinë (prindërit, gjyshërit, prindërit kujdestarë, të tjerët) dhe personat që kanë të drejta dhe detyrime të tjera në lidhje me fëmijën (p.sh. të drejtat e

kontaktit), duhet të përmbahen nga çdo gjë që mund të shkelë marrëdhëniet e fëmijës me persona të tjerë që kanë të drejta dhe detyrime në lidhje me atë fëmijë ose që do ta vështirësonin kryerjen e detyrave të këtyre personave (kërkesat në lidhje me sjelljen e mirë (Wohlverhaltensgebot), neni 159 i Kodit Civil Austriak).

Për përfaqësimin ligjor, kur gjykata vendos për prindëri të përbashkët, atëhere zbatohet parimi i përfaqësimit të pavarur, pra çdo prind ka të drejtën dhe detyrimin të përfaqësojë vetë fëmijën. Prandaj, veprimet juridike të ndërmarra nga njëri prind janë ende të vlefshme, edhe nëse prindi tjetër nuk është dakord me të (neni 167 paragrafi 1 i Kodit Civil Austriak). Marrëveshja e të dy prindërve të autorizuar për të përfaqësuar fëmijën kërkohet vetëm në rastet e përcaktuara në nenin 167 paragrafi 2 i Kodit Civil Austriak (p.sh. kur ndryshohet emrin ose mbiemri i fëmijës, zgjidhet ose ndryshohet feja e fëmijës, transferohet fëmija në kujdesin e jashtëm, të tjetrit. , etj.). Miratimi i prindit tjetër i autorizuar për të përfaqësuar fëmijën dhe pëlqimi i gjykatës kërkohet kur fëmija përfaqësohet ose jepet pëlqimi në emër të fëmijës në çështjet pronësore që nuk janë pjesë e rrjedhës normale të biznesit (neni 167). paragrafi 3 i Kodit Civil Austriak). Kjo përfshin, për shembull, shitjen ose ngarkimin e pasurisë, heqjen dorë nga e drejta e trashëgimisë, pranimin ose refuzimin e pakushtëzuar të trashëgimisë dhe pranimin e dhuratave me vlerë.⁴⁸

Në procedurën civile, çdo prind është i autorizuar të përfaqësojë në mënyrë të pavarur fëmijën. Nëse prindërit nuk mund të bien dakord ose gjykata nuk ka caktuar asnjërin prej tyre ose një palë të tretë si përfaqësues të fëmijës, përfaqësuesi do të jetë prindi që kryen veprimin e parë procedural (Verfahrenshandlung) (neni 169 i Kodit Civil Austriak). Prindërit duhet të respektojnë kërkesat e sjelljes së mirë.⁴⁹

⁴⁸ Country-reports-for-Austria

⁴⁹ Civil code of Austria

SUEDIA

Në Suedi, koncepti i kujdesit të përbashkët ka kaluar në mënyrë evolutive, përmes legjislacionit. Që nga reforma e vitit 1977 kur u prezantua kujdestaria e përbashkët deri në ndryshimet e vitit 1983, gjykata vendoste për çdo rast shkurorëzim. Ky vendim e përcaktonte formën e kujdesit, si përkujdesje e përbashkët, ose si kujdes i pavarur i njërit prind. Sipas ndryshimeve të vitit 1983 kujdestaria e përbashkët ka mbetur edhe pas shkurorëzimit, nëse prindërit nuk bëjnë kërkesë për kujdes të pavarur. Ky ndryshim tregon tendencën e ligjit suedez për t'u kujdesur bashkërisht edhe pas shkurorëzimit. Në vitin 1998 është miratuar Ligji për kujdesin (e përbashkët) ku ceket qëndrimi dhe mardhëdhënjet personale të anëtarve në përkujdesje.

Sipas këtij ligji duhet të sigurohet kujdes i përbashkët për fëmijët. Qëllimi në çdo rast është individual, kur përcaktohet se kjo formë kujdesi është në interesin më të mirë të fëmijës edhe pse prindërit nuk jetojnë së bashku. Para rregullimit me këtë reformë, kujdestaria e përbashkët duhej të ndërpritej nëse një nga prindërit e bën një kërkesë të tillë, ose nëse kundërshtonin të vazhdonin së bashku përkujdesjen. Përveç kësaj, në rast se kujdestaria ka një prind, rregulli ishte se gjykata nuk mund të përcaktonte kujdestarinë e përbashkët me propozimin të prindit tjetër, nëse prindi që kujdeset për fëmijën është kundër tij. Megjithatë, sipas vendimit të ri, gjykata mund të caktojë kujdestarinë e përbashkët dhe kur një prind është kundër. Në këtë rast, përcaktohet kujdesi i përbashkët me shumë kujdes dhe ndjeshmëri. Nëse personi që kundërshton kërkesën e tjetrit prind, duhet të jep arsye të rëndësishme për qëndrimin e tij ndaj kujdesit. Zakonisht preferohet të bëhet përpjekje që të mos vendoset kundër vullnetit të tij. Nëse pala tjetër bazohet në fakte të tilla si abuzimi nga prindi tjetër, në interes të fëmijës, njërit prind do t'i caktohet kujdestaria e pavarur.

Nëse prindërit shkurorëzohen, kujdestaria e përbashkët vazhdon pa qenë nevoja që gjykata të marrë vendim lidhur me shkurorëzimin. Nëse njëri nga prindërit dëshiron të ndryshojë kujdestarinë, duhet të paraqesë kërkesë për ndërprerjen e kujdestarisë së përbashkët. Nëse

njëri nga prindërit dëshiron të ndryshojë kujdestarinë, gjykata mund të vendosë për çështjen e kujdestarisë. Përpara fillimit të çdo procedimi ligjor në lidhje me kujdestarinë, qëndrimin ose të drejtat e aksesit, prindërit e fëmijës duhet të kenë një intervistë informuese me bordin e mirëqenies. Nëse prindërit bien dakord për ndryshimin, ata mund ta zgjidhin çështjen me marrëveshje pa përfshirjen e gjykatës. Që një marrëveshje e tillë të jetë e vlefshme, ajo duhet të miratohet nga bordi i mirëqenies sociale. E njëjta gjë vlen edhe për pyetjen se me cilin prind duhet të jetojë fëmija dhe si duhet të ketë kontakt me prindin tjetër. Komuna është e obliguar që përmes komisionit për mirëqenie sociale t'u ofrojë prindërve pajtim profesional për të arritur marrëveshje për çështjet që kanë të bëjnë me kujdestarinë, vendbanimin dhe kontaktin. Pajtimi është në baza vullnetare. Prandaj, është e nevojshme që të dy prindërit bashkërisht të kërkojnë pajtimin. Nëse prindërit bien dakord për çështjet që kanë të bëjnë me kujdestarinë, vendbanimin dhe kontaktin, ata mund të nënshkruajnë një marrëveshje e cila, pasi të miratohet nga bordi i mirëqenies, do të ketë të njëjtin efekt si një vendim gjykate. Prej datës 1 mars 2022, prindërit e fëmijës, para se të lejohen të nisin procedurën para gjykatës, si rregull, fillimisht duhet të kenë një intervistë informuese me komunën. Kjo do të thotë që prindërit duhet së pari të kontaktojnë komunën për të provuar të zgjidhin mosmarrëveshjen me mbështetjen e bordit komunal të mirëqenies (shërbimi i njohur si shërbimi i ligjit për familjen).

Për mbajtjen e këtyre intervistave është përgjegjës komisioni i mirëqenies sociale i komunës ku është regjistruar fëmija. Gjatë intervistave informative, prindërit marrin informacionin përkatës të nevojshëm për të gjetur zgjidhjen më të mirë për fëmijën e tyre kur bëhet fjalë për çështjet e kujdestarisë, vendbanimit dhe aksesit.⁵⁰ Kujdestaria e përbashkët nënkupton që prindërit duhet të marrin vendime së bashku për çështjet që lidhen me fëmijën. Pika fillestare është që prindërit bien dakord për të gjitha çështjet që lidhen me fëmijën. Megjithatë, mosmarrëveshjet për çështjet e kontaktit me fëmijën dhe vendndodhjen e tij mund të zgjidhen nga gjykata.

⁵⁰ Country reports for Sweden.

Çështjet që lidhen me kujdestarinë, vendbanimin dhe kontaktin mund të zgjidhen edhe në procedurat e shkurorëzimit.

GJERMANIA

Sipas ligjit gjerman, kujdesi i përbashkët pas shkurorëzimit, deri në ndryshimet nga viti 1998, me nenin 1671 pika 4; shprehimisht ishte i ndaluar. Ligji parashikonte që kujdestaria pas shkurorëzimit t'i caktohet njërit prind dhe për një kohë të gjatë konsiderohej se kujdesi i njërit prind është një zgjidhje më e mirë. Megjithatë, në vendimin e Gjykatës Kushtetuese Federale nga viti 1982 u shpreh mendimi se një rregull e tillë vlen për prindërit sipas të drejtave të garantuara me kushtetutë (neni 1. 6. par. 2. fjali. 1. i Ligjit themelor) dhe për këtë arsye vendimi i përparmë shpallet i pavlefshëm. Pas kësaj, gjykatat filluan të praktikojnë dhënien e kujdestarisë së përbashkët, ndonëse me shumë kujdes. Hulumtimi rajonal tregoi se në vitin 1994/95 është dhënë kujdestaria e përbashkët në 17% të shkurorëzimeve, kujdesi për nënën në 74%, dhe për babain në 8%. Rezultatet e hulumtimit nga viti 1994 tregojnë se kujdesi i nënës është më i qëndrueshëm në 90% të rasteve, ai i babait në 83% të rasteve dhe ajo e përbashkëta në 67% të rasteve. Në 90% të rasteve, prindërit kanë arritur një marrëveshje të përbashkët për kujdestarinë. Kur propozimi për formën e kujdesit bëhet nga specialistë, kriteret për propozimin formohet nga marrëdhënia e fëmijës me prindërit dhe dëshira e fëmijës për ta pranuar një kujdes të këtillë. Në shumicën e rasteve rekomandimi i specialistit përfshin vazhdimësinë në jetën e fëmijës si një gjendje aktuale të kujdesit. Ky rezultat, siç shpjegohet në studimi, duhet t'i atribuohet faktit se shumica e fëmijëve kanë marrëdhënie më të mira me anëtarët të familjes në të cilën jetojnë në momentin e vlerësimit.

Ligji i ri për Fëmijët u miratua në Gjermani në vitin 1997 dhe hyri në fuqi në vitin 1998. Propozim për reformën e Ligjit për Fëmijët (Kindschaftsrecht) nga viti 1996, dhe ajo që u

miratua me ligjin e ri, prezanton një fakt të ri ku në Kodin Civil thuhet: “Nëse prindërit që kanë kujdestarinë e përbashkët për fëmijën, secili nga prindërit mund ta prish bashkëjetesën, por jo vetëm përkohësisht, ai mund të kërkojë nga gjykata familjare që t’i jepet kujdestaria e pavarur ose pjesë e kujdesit prindërorë”. Në nënparagrafin 2 thuhet: “Kërkesa duhet të miratohet nëse:

- a) prindi tjetër është dakord, përveç rastit kur fëmija është mbi 14 vjeç dhe nëse nuk pajtohet
- b) nëse mund të supozohet se ndërprerja e kujdestarisë së përbashkët dhe transferimi te paditësi në masën më të madhe i përgjigjet mirëqenies së fëmijës.

Formulimi i ri i kujdesit nënkupton atë gjendje ku kujdestaria vazhdon pas shkurorëzimit, pa qenë nevoja që gjykata të vendosë për të. Megjithatë, me kërkesë të njërit prej prindërve, gjykata e familjes mund t’u japë prindërve të drejtën e kujdesit të përbashkët prindëror nëse kjo është në interesin më të mirë të fëmijës. Konsiderohet se kujdesi i përbashkët prindëror është në interesin më të mirë të fëmijës nëse prindi tjetër nuk paraqet ndonjë arsye për mosdhënien e tij dhe nëse nuk ka ndonjë arsye tjetër të dukshme. Në të drejtën gjermane, supozohet se përgjithësisht është në interesin më të mirë të fëmijës që të ketë kontakt me të dy prindërit, dhe për këtë arsye e drejta e fëmijës për të kontaktuar me prindërit është e garantuar. Gjithashtu, të dy prindërit kanë të drejtën dhe detyrimin për të mbajtur kontakte me fëmijën e tyre.

Para së gjithash, e drejta për të kontaktuar u jep prindërve të drejtën të shohin dhe të flasin rregullisht me fëmijën e tyre. Përveç kontaktit të drejtpërdrejtë, ai përfshin edhe kontaktin me postë dhe telefon. Në përgjithësi, është detyrë e të dy prindërve të ofrojnë mbështetje për fëmijët. Prindërit mund të zgjedhin vetë se si t’i mbështesin fëmijët e tyre.⁵¹

Nëse prindërit jetojnë të ndarë, Zyra e Mirëqenies Rinore mund t’i ndihmojë ata të hartojnë një plan të kujdesit prindëror që është i pranueshëm për të dyja palët. Vendimet gjyqësore për

⁵¹ Responsibility child custody and contact rights GERMANY

kujdesin prindëror mund të bazohen në këtë plan. Nëse prindërit bien dakord që njërit prej prindërve t'i jepet e drejta për të ushtruar kujdesin prindëror në mënyrë të pavarur, ata mund t'i kërkojnë gjykatës familjare transferimin e të drejtës për të ushtruar kujdesin prindëror. Prindërit gjithashtu mund të bien dakord se si të menaxhojnë të drejtat e kontaktit, duke qenë se nuk ka kërkesa. Nëse marrëveshja e prindërve regjistrohet si pjesë e një marrëveshjeje gjyqësore dhe gjykata e miraton atë, ajo marrëveshje është e barabartë me një vendim gjyqësor detyrues dhe, nëse është e nevojshme, është i detyrueshëm.

Nëse prindërit nuk janë në gjendje t'i zgjidhin vetë konfliktet e tyre, ata mund të kontaktojnë Zyrën e Mirëqenies Rinore ose shërbimin vullnetar të mbështetjes për mirëqenien e të rinjve (Freie Jugendhilfe). Ata japin këshilla për prindërit dhe i ndihmojnë ata të kapërcejnë problemet. Pajtimi gjithashtu mund t'i ndihmojë prindërit të zgjidhin mosmarrëveshjet në mënyrë paqësore.

4.7. Praktika gjyqësore lidhur me shkurorëzimet dhe kujdestarinë e fëmijëve - raste nga Gjykata Themelore në Tetovë

Përveç aspekteve juridike teorike, gjatë punimit të kësaj teme janë marrë dhe analizuar edhe disa raste nga Gjykata Themelore në Tetovë .

Rasti 1: Shkurorëzimi i martesës

Përshkrimi i rastit: Gjykata Themelore në Tetovë, P2-410/22 i datës 12.10.2022

Paditësja K.D nga ..., Rr..., ka paraqitur padi kundër të paditurit Q.N nga..., Rr..., duke theksuar se palët kanë lidhur martesë më datë 23.11.2016. Ata kanë jetuar sëbashku dhe në fillim raportet martesore kanë qenë të mira por më vonë janë shfaqur mosmarrëveshje dhe zënka përshkak të mospërshtatjes së mentaliteteve të tyre dhe për këtë arsye e kanë shkëputur bashkësinë martesore, e njëjta nuk ka pasur gjasa të rivendoset për shkak se jeta e përbashkët është bërë e padurueshme. Fëmijë nuk kanë.

Aktgjykimi i Gjykatës themelore në Tetovë, *Π2-410/22* i datës 12.10.2022: zgjidhet me SHKURORËZIM martesa e lidhur mes paditëses K.D nga..., e lindur më datë 25.12.1974 dhe të paditurit Q.N nga..., I lindur më datë 26.08.1972, e lidhur me date 23.11.2016, regjistruar me nr. rendor 86.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata ka vlerësuar se kushtet për shkurorëzim të martesës janë plotësuar. Sipas nenit 40 të Ligjit për Familje, martesa mund të shkurorëzohet me kërkesë të njërit bashkëshort nëse raportet martesore janë çregulluar deri në atë masë sa jeta e përbashkët është bërë e padurueshme, e në veçanti me atë se martesa paraqet vullnet të lirë dhe e njëjta mund të përfundojë me vullnetin e lire të njërit bashkëshort, e në këtë rast kemi vullnetin e të dy bashkëshortëve.

Rasti 2: Shkurorëzimi i martesës me marrëveshje

Përshkrimi i rastit: Gjykata Themelore në Tetovë, Π2-106/22 i datës 25.02.2022

Propozuesi R.B nga f... dhe propozuesja F.B nga f..., komuna e Tetovës , kanë bërë propozim të përbashkët për zgjidhjen e martesës së lidhur më 09.07.2003. Nga kjo martesë propozuesit kanë 2 fëmijë të mitur: A.B. e lindur më 28.11.2008 dhe A.B I lindur më 27.11.2009. Vendimin për shkurorëzim e kanë marrë vet, pa asnjë detyrim ose lloj kërcënimi. Gjithashtu edhe për kujdestarinë e fëmijëve kanë aritur marrëveshje që ti besohen babait për përkujdesje dhe edukim, ndërsa nëna mer përgjegjësi të paguaj alimentacionin (mbajtjen) në vlerë prej 2.000 denar për secilin fëmijë nga data e nxjerjes së aktgjykimit.

Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Tetovë, *Π2-106/22* i datës 25.02.2022: zgjidhet me SHKURORËZIM martesa e lidhur në, e regjistruar me nr.rendor 41 për vitin 2003, mes propozuesit R.B nga....., lindur më datë 30.08.1979 dhe të propozueses F.B nga....., lindur më

date 11.10.1978, në pajtim me nenin 39 të Ligjit për Familje. Fëmijët e mitur, i besohen babait për përkujdesje të mëtutjeshme, edukim dhe mbajtje. Detyrohet propozuesja të paguajë alimentacionin në shumë prej 2.000 denarësh për secilin fëmijë, më së voni deri në datën 5 të muajit, në dorë t'ia dorëzojë propozuesit- babait, duke llogaritur nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit, e deri sa ka kushte ligjore për të.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata për marrjen e këtij aktgjykimi u bazua pas nxjerrjes së provave të propozuara edhe atë me leximin e marrëveshjes nga 02.02.2022 dhe dëgjimit të propozuesve në cilësi të palës, në përputhje me nenin 39 të Ligjit për Familje, martesë mund të shkurorëzohet me pajtim të përbashkët të bashkëshortëve dhe në rastin konkret propozuesit personalisht para gjykatës e vërtetuan vendimin e përbashkët për shkurorëzim dhe kujdestari të fëmijëve të mitur, me çka gjykatës i mbetet të miratojë propozimin e përbashkët dhe të shkurorëzojë martesën.

Rasti 3: Shkurorëzimi i martesës me padi

Përshkrimi i rastit: Gjykata Themelore në Tetovë, P2-379/22 i datës 03.03.2023

Paditësi S.A nga f...., ka paraqitur padi kundër paditëses I.A nga f...., duke theksuar se palët kanë lidhur martesë më datë 21.05.2021. Në fillim raportet martesore I kanë pasur të mira, por për shkak të mosmarrëveshjeve ka ardhur deri në prishjen e këtyre raporteve dhe për shkurorëzim të martesës. Nga kjo martesë kanë 1 fëmijë të mitur P.A e lindur më 30.05.2021. Me kërkesë të paditësit dhe pajtim të paditëses martesë është shkurorëzuar dhe vajza e mitur I besohet babait, ndërsa e paditura të mbajë kontakte të rregullta ashtu siç janë marrë vesh.

Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Tetovë, P2-379/22 i datës 03.03.2023: Aprovohet kërkesëpadija e paditësit S.A nga f.... Martesa e lidhur më datë 21.05.2021 në me nr. rendor 25 për vitin 2021, mes paditësit S.A lindur më 16.11.1996 dhe I.A e lindur më 08.12.1996, SHKURORËZOHET në pajtim me nenin 40 të Ligjit për Familje. Vajza e mitur P.A lindur më datë

30.05.2021, I besohet në përkujdesje , edukim dhe mbajtje paditësit si baba , ndërsa nëna të mbajë kontakte të rregullta me fëmijën.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata për marrjen e këtij aktgjykimi u bazua me nxjerjen e provave të propozuara si dhe me marrje në pyetje të palëve të cilët para gjykatës, kategorikisht vërtetuan se nuk duan ta vazhdojnë jetën e përbashkët martesore. Nga provat materiale dhe verbale, gjykata shkurorëzoi martesën në bazë të nenit 40 të Ligjit për Familje sipas të cilit: martesa mund të shkurorëzohet me kërkesë të njërit bashkëshort, nëse raportet martesore janë çregulluar deri në atë masë sa jeta e përbashkët është bërë e padurueshme. Fëmijën e mitur P.A e besoi tek paditësi – babai, me çka e kishe parasysh edhe mendimin e Qendrës për Punë Sociale Tetovë ku ishte paraparë që fëmija i mitur ti besohet nënës përshkak të moshës, por gjatë procedurës mes palëve është bërë marrëveshje që fëmija i mitur ti besohet babait dhe nëna të mbajë kontakte të rregullta edhe atë gjys jave me nënën më saktësisht nga e mërkura deri të diellën, tek paditësi- babai nga e hëna deri të mërkurën.

Rasti 4: Shkurorëzimi i martesës

Përshkrimi i rastit: Gjykata Themelore në Tetovë, П2-310/22 i datës 12.12.2022

Paditësi A.I nga f..., ka paraqitur padi kundër paditëses L.N nga f..., duke theksuar se palët kanë lidhur martesë më datë 08.07.1999. Nga kjo martesë kanë 1 fëmijë të mitur F.N i lindur më 07.08.2006. Për shkak të prishjes së raporteve martesore, të njëjtat janë përkeqësuar, jeta e përbashkët është bërë e padurueshme dhe për këtë arsye është bërë shkurorëzimi dhe fëmija i mitur ti besohet babait, ndërsa e paditura të paguaj alimentacion në vlerë prej 2000 denarë në muaj.

Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Tetovë, П2-310/22 i datës 12.12.2022: Aprovohet kërkesa e paditësit A.I nga f... Martesa e lidhur më datë 08.07.1999 në f..., me nr rendor 13 për vitin 1999,

mes paditësit A.I i lindur më 01.01.1977 në f..., dhe paditëses L.N nga f..., e lindur më 20.12.1976, SHKURORËZOHET , në pajtim me nenin 40 të Ligjit për Familje.

Fëmija i mitur F.N i lindur më 07.08.2006 i jepet në perkujdesje babait. Detyrohet e paditura të paguaj për fëmijën e mitur alimentacion në vlerë prej 2000 denarve, më së voni deri në datën 10 të muajit nëpërmjet postës ose të ja dorëzon në dorë babait – si përfaqësues ligjor.

Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata për marrjen e këtij Aktgjykimi ka zbatuar Ligji për Familjen nenin 40 i cili parasheh se martesë mund të shkurorëzohet me kërkesë të njërit prej bashkëshortëve nëse raportet martesore janë çregulluar deri në atë masë sa jeta e përbashkët është bërë e padurueshme. Në rastin konkret, në bazë të provave dhe dëgjimit personalisht të të paditurës e cila pajtohet me shkurorëzimin janë plotësuar kushtet për shkurorëzim. Në pajtim me nenin 80 të Ligjit për Familje me aktgjykimin me të cilin shkurorëzohet martesë, gjykata vendos për kujdesin, edukimin dhe mbajtjen e fëmijëve të përbashkët. Në këtë rast fëmijën e mitur F.N gjykata ia besoi për kujdes, edukim dhe mbajtje babait, duke pasur parasysh edhe mendimin e Qendrës për Punë Sociale, pajtimin e nënës dhe në veçanti dëshirën e madhe të fëmijës të qëndrojë me babain.

Rasti 5: Shkurorëzimi i martesës

Përshkrimi i rastit: Gjykata Themelore në Tetovë, П2-250/22 i datës 31.08.2022

Paditësi R.Z nga f..., ka lidhur martesë me të paditurën Z.Z nga, . Për shkak të perceptimeve të ndryshme ndaj martesës dhe mospërputhjes së karaktereve, zënkat e shpeshta, raportet u janë prishur deri në atë masë sa jeta e përbashkët është bërë e padurueshme dhe e paditura ka braktisur bashkësinë martesore dhe është kthyer te prindërit. Ka kërkuar nga gjykata që fëmija t'i jepet babait ndërsa ajo do të paguajë alimentacion në vlerë prej 1000 denar.

Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Tetovë П2-250/22 i datës 31.08.2022 : Aprovohet kërkespacia e paditësit R.Z nga... Martesa e lidhur më date 05.09.2017 në Tetovë, me numër rendor 96 për vitin 2017, mes paditësit R.Z lindur më 01.05.1992 në f..., dhe të paditurës Z.Z e lindur më 08.05.1994 në f..., SHKURORËZOHET në bazë të nenit 40 të Ligjit për Familje. Fëmija i mitur i besohet babait për përkujdesje të mëtutjeshme, edukim dhe mbajtje. Detyrohet e paditura të paguaj alimentacion në vlerë prej 1000 denar në muaj për fëmijën e mitur.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata për marjen e këtij aktgjykimi ka vendosur pas shqyrtimit të provave të paraqitura, dëgjim të paditurës si palë, si dhe duke pasur parasysh se janë njohur me shkuesi dhe kanë lidhur martesë. Nga kjo martesë kanë një vajzë të mitur E.Z e lindur më 18.04.2018. Prej në fillim raportet martesore nuk i kanë pasur të mira, dhe me kalimin e kohës ato raporte janë çregulluar deri në atë masë sa jeta e përbashkët është bërë e padurueshme dhe e paditura ka braktisur bashkësinë martesore dhe ka shkuar të jetojë tek prindërit, gjithashtu mes bashkëshortëve nuk ka pasur vullnet që të vazhdojnë të jetojnë sëbashku. Gjykata pas marjes në pyetje të të paditurës dhe mendimit të QPS ku thuhet se e paditura është e pajtuar me shkurorëzimin dhe pajtohet që vajza e mitur ti jepet në përkujdesje babait, vendos që vajza e mitur ti jepet babait për përkudjesje dhe edukim, duke vlerësuar se ky vendim do të ndikojë pozitivisht duke pasur parasysh moshën e saj si dhe kushtet më të mira për jetë dhe shkollim të mëtutjeshëm. Gjykata në bazë të nenit 179,194,195,196 dhe neni 274 të Ligjit për Familje e detyroi të paditurën për alimentacion për fëmijën në vlerë prej 1.000 denarve, më së voni deri në datën 5 të muajit mes postës ose në dorë përfaqësuesit ligjor- babait.

4.8. Raste nga Qendra për Punë Sociale Tetovë

Sa herë që një fëmijë të përfshihet në çfarëdo lloj cilësie në procedurën gjyqësore , angazhimi i QPS-së është i detyrueshëm. Qendra për Punë Sociale është kompetente që deri te gjykata të dërgojë *mendim* mbi atë se cilit nga prindërit duhet t'i besohen fëmijët për përkujdesje dhe edukim. Në vijim do të përshkruaj disa raste në lidhje me ushtrimin e të drejtës prindërore pas shkurorëzimit të martesës, marrë nga Qendra për Punë Sociale Tetovë.

Rasti 1

Institucioni publik –Qendra Ndërkomunale e Punës Sociale – Tetovë , në bazë të nenit 14,76 dhe nenit 79 të Ligjit për Familje, duke vepruar sipas kërkesës nr.08-189 nga 14.08.2023 , të babait A.A nga f. ...,për rregullim të kontakteve personale me fëmijën e mitur A.A e lindur më 12.07.2020 në Itali.

AKTVENDIM

RREGULLOHEN kontaktet personale të vajzës së mitur A.A dhe babit të saj A.A. Fëmija i mitur është lindur nga martesa mes M.A dhe A.A. Martesa është e shkurorëzuar, ndërsa e mitura A.A e lindur më 12.07.2020 me aktgjykim të gjykatës themelore në Tetovë i besohet nënës M.A.

Kontaktet do të rregullohen në këtë mënyrë: Cdo vit në kohën e verës , duke pasur parasysh se babai i të miturës është me punë në Itali, gjithmonë kur babai do të jetë në Maqedonine e Veriut prej 10.08. deri me 17.08. ta marrë vajzën e mitur A.A në ora 11:00 dhe ta kthejë ora 18:00 tek nëna. Në kohën e dimrit kur babai të jetë në RMV nga data 15.12 deri 21.12, pa fjetje,vajza e mitur A.A të jetë me babain, duke e marrë ora 11:00 dhe ta kthejë ora 18:00. Fëmijën ta marrë baba A.A dhe ta kthejë tek nëna M.A.

Detyrohen prindërit të veprojnë në bazë të këtij vendimi.

-Detyrohet nëna e të miturës A.A , ta bëjë gati dhe në kohë në takimet me babain.

-Detyrohet babai t'i respektojë terminet për kontaktet personale me vajzën.

-Detyrohen të dy prindërit që takimet që u ikin me arsyetim (Ne rast se fëmija është sëmure) t'i realizojnë në ditën tjetër, në pajtim me nevojat e fëmijës, duke mos e prishur dinamikën e takimeve. Prindi që nuk ka mundësi ta realizoj takimin me terminet e caktuara në vendim, minimum një ditë më parë ta informoj prindin tjetër për mos realizimin e takimit dhe arsyet për të njëjtin. Prindërit për çdo ndryshim tek fëmijët, në kohë dhe rregullisht të njoftohen mes vete.

Prindërit e A.A janë të detyruar t'u përmbahen pikave të këtij vendimi dhe të krijojnë një marrëdhënie pozitive për realizim të të drejtës së theksuar të fëmijës.

Rasti 2

Institucioni publik –Qendra Ndërkomunale e Punës Sociale – Tetovë, duke vepruar sipas kërkesës УП.6p.1001-13 data 16.01.2024 , të J.S nga f..., për marrjen e vajzës së mitur nga bashkësia jashtëmartesore, në kujdes të mëtutjeshëm, rruajtje dhe edukim.

Ekipi profesional i IP-Qendra Nderkomunale e punës sociale, ngriti procedurë, ndërmori veprimet e nevojshme procedurale, bëri biseda këshilluese me babain dhe nënën. Nga E.J dhe J.S janë marë deklarata me shkrim. Partnerët J.S dhe E.J kanë formuar bashkësi jashtëmartesore në të cilën ne datë 14.10.2022 është lindur vajza e mitur H.S. Për shkak të çregullimit të marrëdhënieve mes tyre, bashkësia jashtëmartesore është ndërprerë. Nëna E.J në deklaratën me shkrim të dhënë në Qendër, deklaroi se pajtohet që vajza e mitur ti jepet babait në kujdes, ruajtje dhe edukim, dhe asaj ti mundësohen takimet me të. Gjithashtu babai J.S deklaroi se do ta mer plotësisht kujdesin mbi vajzën.

AKTVENDIM

1. I jepet vajza e mitur H.S e lindur më 14.10.2022 në Tetovë, në bashkësi jashtëmartesore mes J.S dhe E.J, në kujdesje të mëtutjeshme, ruajtje dhe edukim babait J.S.

Detyrohen prindërit të veprojnë në bazë të pikave të këtij vendimi.

Është në interes të vajzës të jetojë me babain për shkak të kujdesit të tij të vazhdueshëm ndaj saj dhe gadishmërinë të kujdeset edhe me tutje për vajzën, përmbushjen e kërkesave të saj, ndërsa nëna E.J pa ndërprer t'i realizoj të gjitha të drejtat dhe detyrimet si prind.

Rasti 3

Institucioni publik –Qendra Ndërkomunale e Punës Sociale – Tetovë, duke vepruar sipas kërkesës 08-242 nga 05.10.2023 , nga nëna E.M nga f..., për rregullim të kontakteve personale të vajzës së mitur A.M me babain me të cilin nuk bashkëjeton, ekipi profesional i ndërmori të gjitha veprimet procedurale, vërejti shkresat në lëndë, bëri takim këshillues me nënën dhe babain e fëmijës së mitur, mori deklaratë nga ato, prej ku edhe e nxori vendimin. K.M dhe E.m kanë lidhur martesë në vitin 2016. Nga kjo martesë është lindur vajza e mitur A.M. përshkak të prishjes së raporteve martesore martesë mes tyre është shkurorëzuar dhe vajza e mitur i jepet nënës për ruajtje, edukim dhe mbajtje të mëtutjeshme. Pasi është në interes të fëmijës që të mbajë kontakte edhe me prindin që nuk jeton, mendojmë se rregullimi i kontakteve me babain do të ndikojë pozitivisht për zhvillimin e saj psikik dhe social, sepse e mitura ka nevojë për dashurinë dhe ngrohtësinë e babait. Prandaj vendosem si në dispozitivin e vendimit.

AKTVENDIM

Fëmija i mitur A.M e lindur më 19.01.2021 të mbajë kontakte të rregullta me babain K.M. Çdo të parën dhe të tretën të shtunë ti kalojë me babain nga ora 12:00 deri ora 16:00. Festat e Bajramit cdo vit do ti kalojë me babain nga ora 12:00 deri 16:00.

Detyrohet nëna E.M të mundësojë mbajtjen e kontakteve personale të vajzës A.M me babain e saj, ta bëjë gati në kohë për takimet me babain. Të mundësojë komunikim me telefon të vajzës me babain.

Detyrohet babai t'i respektojë terminet për kontaktet personale me vajzën.

Detyrohen të dy prindërit që takimet që u ikin me arsyetim (Ne rast se femija është sëmur) t'i realizojnë në ditën tjetër, në pajtim me nevojat e fëmijës, duke mos e prishur dinamikën e takimeve. Prindi që nuk ka mundësi ta realizoj takimin me terminet e caktuara në vendim, minimum një ditë më parë ta informoj prindin tjetër për mos realizimin e takimit dhe arsyet për të njëjtin. Prindërit për cdo ndryshim tek fëmijët ,në kohë dhe rregullisht të njoftohen mes vete.

Gjithçka që është në marrëveshje mes prindërve dhe nuk është cek në Vendim, ekipi profesionist do ta respektoj si marrëveshje e prindërve në interes të fëmijës së mitur.

PËRFUNDIME

Duke u nisur nga përvojat juridike, në rend të parë, të Ligjit për familje e më pastaj edhe të Kodeve familjare të disa vendeve fqinje dhe të disave nga ato të Bashkimit Evropian dhe duke marrë parasysh se shumë çështje që i takojnë raporteve mbrenda familjes, gjatë funksionimit normal të saj, po edhe për çështjet tjera që janë rrjedhojë e prishjes së ekuilibrit ndërpersonal në suaza të familjes që përfundojnë me shkurorëzim, e pash të arsyeshme që të qasem ndaj një pune tejet delikate dhe kryesisht të re në jurisprudencën si të RMV-së, ashtu edhe të vet Bashkimit Evropian.

Shiquar nga këndvështrimi juridik, pjesa më e ndijshme e këtyre raporteve brenda familjare i takon fatit të fëmijëve të mitur mbas shkurorëzimit dhe lidhjes, gjegjësisht raporteve të tyre me prindërit, tani më të shkurorëzuar, të cilët konform aspekteve etike e morale, pra edhe si rrjedhojë e rregullativave juridike, duhet të ken për obligim të gjejnë zgjidhje optimale për kujdesin e fëmijëve edhe pas shkurorëzimit. Meqenëse legjislatura e RMV-së, këtë materje, nga këndvështrimi juridik e trajton përmes Ligjit për familje është e nevojshme të bëhen përpjekje që tematika e ndërlidhur me çështjen e shkurorëzimit dhe kujdesi ndaj fëmijëve pas shkurorëzimit të sistematizohen në një ligj të veçantë. Prandaj mendoj se është më se e nevojshme të bëhen ndryshimet ligjore për rregullimin e statusit të prindërisë së përbashkët pas shkurorëzimit të martesës, gjegjësisht inkorporimin e prindërisë së përbashkët në kapitull të veçantë të Ligjit për familje ose përpilimin e Kodit civil të ri në RMV ku do të përfshihet përmbajtja e të drejtave prindërore në RMV e cila duhet të ndryshohet dhe përshtatet me të drejtat dhe interesat e fëmijës si subjekt qendror i marrëdhënieve juridike në familje, duke trajtuar në mënyrë më sistematike raportet mbrenda në familje, sidomos rastet pas shkurorëzimit të martesës dhe prindërinë.

Për fat të keq, fenomenologjia e krizës në familje në të shumtën e rasteve, gjat trajtimit juridik nëpër gjykata, në të shumtën e rasteve shkakton krizë gjatë këtyre procedurave ligjore, duke e ritur pakënaqësinë e palëve në kontest.

Kujtoj se angazhimi hulumtues në këtë lëmi të jurisprudencës që nga gjykatat kërkon kujdes të veçantë trajtimi bazuar në ligje të qarta, sadopakë do të kontribuonte në qartësimin dhe precizimin ligjor të zgjidhjes së këtyre krizave familjare e veçmas në sigurimin e mirëqenies së fëmijëve në këto konteste ndërprindërore gjatë shuarjes së bashkëshortësisë si pasojë e shkurorëzimit. Prandaj pajtohem me konstatimin e psikologut Craig Childers se „me lindjen e fëmijës krijohet familja dhe se ajo gjithëmonë do egzistoj, sepse me shkurorëzimin prishet martesë dhe jo familja dhe fëmijët janë ata që e mbajnë familjen”.

Se me funksionimin e prindërisë së përbashkët edhe pas shkurorëzimit, familja vazhdon të funksionoj, është edhe konstatimi im. Prandaj prindërisë së përbashkët duhet dhënë rëndësi të veçantë në sferën e jurisprudencës.

REKOMANDIME

Rekomandimet lidhur me impaktin e prindërisë së përbashkët në RMV janë të rëndësishme për të adresuar sfidat dhe përmirësuar situatën aktuale pasi tranzicionet e ndryshme politike, ekonomike dhe sociale, përmes të cilave ka kaluar shoqëria e RMV si dhe vet mentaliteti i shoqërisë ka ndikuar në ngadalësimin e proceseve dhe reformave në të gjitha sferat.

Në këtë drejtim disa rekomandime të vlefshme janë si vijon :

- Rritjen e ndërgjegjes së vet shoqërisë, lidhur me të drejtat ligjore që u takojnë .
- Zhvillimi i aktiviteteve që kanë të bëjnë me edukimin dhe ngritjen e vetëdijes tek qytetarët e sidomos tek anëtarët e familjes në vendin tonë lidhur me shkurorëzimin dhe kujdestarinë(në rrethinën tonë ende gjykohet pala e cila ka inicuar shkurorëzimin).
- Përpilimi i projekteve të ndryshme që nxisin qytetarët e veçanërisht bashkëshortët apo prindërit në ndryshime pozitive sociale- Institucionet duhet të hartojnë dhe të zbatohen ligje dhe politika të përkushtuara për të promovuar prindërinë e përbashkët pas

shkurorëzimit. Këto dokumente duhet të jenë të përgjegjshme dhe të përputhshme me standardet ndërkombëtare për të garantuar të drejtat për të dy prindërit.

- Hapja e qendrave të ndryshme në formë të Këshillimoreve për të ndihmuar çiftet e shkurorëzuara që kanë fëmijë lidhur me ushtrimin e të drejtave prindërore në mënyrë sa me efektive duke respektuar gjithmonë interesin më të lartë të fëmijës.
- Organizim i konferencave dhe takimeve të ndryshme nga institucionet lokale me qëllim të promovimit të dialogut dhe bashkëpunimit mes prindërve të shkurorëzuar – kjo ndihmon në zhvillimin e politikave dhe praktikave të mira si dhe përfortim të raporteve familjare edhe pas shkurorëzimit.
- Vendosja e një bashkëpunimi të mirë midis institucioneve të gjyqësisë dhe Qendrës për punë sociale – këto institucione duhet të përmirësojnë transparencën dhe të bëjnë ndjekjen e procedurave të rregullta dhe të drejta duke favorizuar gjithmonë interesin më të lartë të fëmijës.
- Mediat, lëvizjet qytetare, qendrat sociale, organizatat e ndryshme duhet të aktivizohen në drejtim të këshillimit ,edukimit dhe platformave të ndryshme për ndihmë prindërve dhe këshillim adekuattë të fëmijëve.

Konform këtyre rekomandimeve të përgjithësuara, rekomandim kryesor që bazohet hulumtimi është që:

- Ligji për familje i RMV të plotësohet me dispozita ligjore të cilat në mënyrë më të detajuar do të shtjellonin çështjet familjare, sidomos shkurorëzimin dhe të drejtat prindërore si dhe të përfshihet në Kodin civil të ri të RMV
- Rekomandohet që në Kodin civil të ri të përfshihet instituti i Prindërisë së përbashkët pas shkurorëzimit. Prindërit me kujdestari të përbashkët ndajnë përgjegjësinë dhe detyrim ligjor për të marrë vendime të rëndësishme për fëmijët e tyre lidhur me rritjen, edukimi, kujdesi mjekësor dhe vendime të tjera prindërore.

- Kryerja e një analize krahasuese të modeleve të ndryshme të prindërisë së përbashkët në juridiksione të ndryshme. Shqyrtimi i implikimeve ligjore, sociale dhe ekonomike të zbatimit të të drejtave të prindërisë së përbashkët , duke marrë parasysh ndryshimet në kontekstet kulturore, traditat ligjore etj.
- Rekomadohet që të hetohen sfidat dhe benefitet e kornizave të ndryshme ligjore dhe të analizohet efektiviteti i mekanizmave të zbatimit në garantimin e të drejtave prindërore.

Bibliografia

Emine Zendeli, Arta Selmani-Bakiu, Dejan Mickoviq, Angel Ristov . *E drejta familjare* , Tetovë 2020

Abdulla Aliu- Haxhi Gashi . *E drejta Familjare*, Prishtinë 2007

Dida,A. *Fillet e sociologjis*, Tetovë 1997

Hasan Jashari. *Familja dhe bashkësia*, Tetovë 2006

Dr.Ragip Halili. *Kriminologjia* , Prishtinë 2005

Мицковиќ Д.Ристов.А. *Семејно право*, Скопје 2015

Мицковиќ Д. *Семејството во Европа од XI до XXI век*, Скопје 2008

Hamdi Podvorica. *E drejta familjare*, Prishtinë 2011

Dr.Sc.R.Lukiq . *Filozofia e së drejtës* ,

Shorter, E. (1977). *The Making of the Modern Family*, Basic Books.

Dr.Ivo Puhani ; *E drejta romake*, botim i pestë, Prishtinë

Hilmi Ismaili&Fatmir Sejdiu, *Historia e shtetit dhe së drejtës*, Prishtinë,2005

Jascueline Murray, *Family Life in the Middle Ages*.

Hurshid Ahmed, *Jeta familjare në Islam*.

Anthony Giddens (2007), *Sociologjia*, Qabej, Tiranë.

A.Mooney, C.Oliver. *Impact of Family Breakdown on children's Well-being*,2009

Cvejić-Jančić, O. *Zajedničko vršenje roditeljskog prava*. Pravni život,1997

Scott.E. & Derdeyn, A. *Rethinking joint custody*,1984

Opie, Anne. *Ideologies of Joint Custody*.*Family Court Review* 31, no.3

Ahrons, C.R. *The binuclear family; Parenting roles and relationships, parent-child relationship post divorce* , Kopenhagen,1984

Ковачек Станић, Гордана. *Аутономија VERSUS материјална истина у компаративном праву о породичном статусу детета*,2011

Leslie J. Harris, Lee E. Teitelbaum. *Children, Parents, and the Law: Public and Private Authority in the Home, Schools, and Juvenile Courts*.

Dokumente, tekste ligjore dhe raporte

Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut , hartuar nga Këshiili i Evropës, në vitin 1950

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, (10 dhjetor 1948), neni 12

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë,miraturar me 17 nëntor 1991, neni 25,26

Konventa Mbi të drejtat e fëmijës ;UNICEF.org.; neni 9

Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF), Rezoluta 44/25 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara e 20 nëntorit 1989, hyrë në fuqi më 02 shtator 1990

Government.no; National Mediation Service

CHILDREN FIRST: The Role of Centres for Social Work in Judicial Proceedings” - OSCE.org

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale të RMV , Protokoll për bashkëpunim ndërsektorial se si të vepohet me fëmijët në rrugë , Shkup 2022

Victoria Mather, Evolution and Revolution in Family Law,"25, St. Mary's L.J. 405 (1993).This Article is brought for free and open access by the School of Law Faculty Scholarship at Digital Commons at St. Mary's University.

Kanuni i Lekë Dukagjinit, libri i dytë Familja, neni 18

Ligji për familjen ,Gazeta zyrtare e RMV, nr.153/14

Ligji për mediacion, Gazeta zyrtare e RMV, nr.138/09

Ligji për procedurë jo-kontestimore i RMV

The Psychological Effects of Divorce on Children - <https://www.verywellfamily.com>

A guide to joint custody -<https://www.noblesolicitors.co.uk/>

Parental responsibility-child custody and contact rights in France; <https://e-justice.europa.eu/>

- <https://www.justia.com/family/child-custody-and-support/child-custody/>

- <https://www.divorcenet.com/topics/child-custody>

- <http://ceflonline.net/wp-content/uploads/Austria-Parental-Responsibilities.pdf>

- <http://ceflonline.net/wp-content/uploads/Sweden-Parental-Responsibilities.pdf>

- <http://ceflonline.net/wp-content/uploads/France-Parental-Responsibilities.pdf>

- <https://www.unicef.org/northmacedonia/mk/roditelstvo>

- <https://www.euro-family.eu/>

- <https://ombudsman.mk/>

- <https://www.unicef.org/child-rights-convention/history-child-rights>

